



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 26 regjistër (JR)  
Datë 29.06.2023

Nr. 67 i vendimit  
Datë 30.09.2025

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 30.09.2025, ora 9:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Jerina Gjika, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 26 (JR), datë 29.06.2023, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Taulant Tafa, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 649, datë 24.04.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Taulant Tafa.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F, pikat 2 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja "b"; ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative"; ligji nr. 49/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative", i ndryshuar.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet e ngritura në parashtrimet me shkrim të datës 19.09.2025, të subjektit të rivlerësimit, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 649, datë 24.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Taulant Tafa, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe, për rrjedhojë, ai gëzonte statusin e magjistratit<sup>1</sup>. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, z. Taulant Tafa iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente brenda afatit ligjor<sup>2</sup>, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë<sup>3</sup>, deklaratën për kontrollin e figurës<sup>4</sup> dhe formularin për vetëvlerësimin profesional<sup>5</sup>.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport<sup>6</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: (i) *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.* (ii) *Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive.* (iii) *Ka*

<sup>1</sup>Neni 2, pika “gj” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se magjistrat është edhe gjyqtari, ndërkohë neni 164, pika 2 e të njëjtit ligj parashikon se gjyqtarët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit, të parashikuar sipas të njëjtit ligj vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit.

<sup>2</sup>Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

<sup>3</sup>Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 27.01.2017, sipas vërtetimit me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.01.2017. Të njëjtën datë mban dhe deklaratat e pasurisë në rubrikën përkatëse.

<sup>4</sup>Referuar raportit mbi kontrollin e figurës të përgatitur nga grupi i punës pranë DSIK-së.

<sup>5</sup>Referuar raportit nr. {\*\*\*} prot., datë 07.06.2018, të Inspektoratit pranë KLD-së për “Analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Taulant Tafa për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016”, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 27.01.2017.

<sup>6</sup>Raporti me nr. {\*\*\*} prot., datë 15.01.2020.

*mosdeklarime ndër vite. (iv) Nuk ka kryer deklarim të rremë. (v) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka dërguar një raport<sup>7</sup> të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit ka konkluduar për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Taulant Tafa për vazhdimin e detyrës. Në vijim, pas kërkesës së Komisionit për përditësimin e raportit të figurës për subjektin e rivlerësimit, DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës, i ka përcjellë Komisionit një tjetër raport<sup>8</sup>, në të cilin ka ndryshuar konstatimin fillestar nga përshtatshmëri, në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.
5. Këshillit i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Taulant Tafa, për të tria kriteret e rivlerësimit, duke marrë vendimin nr. 649, datë 24.04.2023.

## **II.Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

6.1. Me vendimin nr. 649, datë 24.04.2023, me shumicë votash, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Ky vendim është marrë në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

6.2. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: a) *Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vlerën totale prej (-) 11.081.455 lekësh, për periudhën e deklarimit. b) Mungesa e burimeve të ligjshme financiare në vlerën totale prej (-) 11.081.455 lekësh, për periudhën e deklarimit, e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në përputhje me parashikimet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 61 dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. c) Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar burimin e ligjshëm të ndërtimit të banesës dy kate + bodrum + nënçati, me sip. 101 m<sup>2</sup> /kati, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. d) Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të pjesës takuese në pasurinë bodrum, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

---

<sup>7</sup> Raporti fillestar me nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017.

<sup>8</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 01.12.2020, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZh-së nr. {\*\*\*}, datë 09.12.2020.

6.3. Për kriterin e kontrollit të figurës: [...] mospërmbushja e rregullt e detyrës nga subjekti i rivlerësimit cenon pastërtinë e figurës së subjektit dhe shkallën e besueshmërisë së tij në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

6.4. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: [...] edhe nëse mangësitë e konstatuara në vendimet e analizuara të subjektit, në dosjet e shortuara, nuk do të mjaftonin për të kualifikuar subjektin të paaftë profesionalisht, sipas parashikimit të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, referuar problematikave dhe mangësive të evidentuara, në një vlerësim tërësor të rrethanave dhe procedurave ato do të ishin të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. [...] gjetjet në lidhje me vendimet e analizuara, referuar denoncimit të administruar sipas nenit 53, konsiderohen të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

6.5. Në përfundim, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: Subjekti i rivlerësimit Taulant Tafa, në kuptim të parashikimeve të pikave 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën totale prej (-) 11.081.455 lekësh për periudhën e deklaramentit; ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në momentin e krijimit; është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit; ka mosdeklarim të ardhurash në deklaratën vetting. Në vlerësimin tërësor të rrethanave dhe procedurave, subjekti i rivlerësimit Taulant Tafa ka cenuar besimin e publikut të drejtësisë në kuptim të parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

### **III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit**

6.6. Kundër vendimit të Komisionit nr. 649, datë 24.04.2023, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit me pretendimin se ky vendim është pasojë e interpretimit të gabuar të provave, ligjit procedural dhe atij material. Sipas tij, nëpërmjet një hetimi të plotë administrativ do të provohej mungesa e balancës negative ose, së paku, ekzistenca e një balance negative për të cilën subjekti mund të përfitonte zbatimin e parimit të proporcionalitetit.

6.7. Subjekti i rivlerësimit Taulant Tafa nuk e shoqëroi ankimin e tij me akte shkresore, për të cilat të kërkonte marrjen në cilësinë e provave të reja. Bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a”, 63, pika 1, 65 e 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenet 47, 51, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012, si dhe në nenet 108, 109 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, kërkoi që Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim referuar “Kolegji”) të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë: (i) Riçeljen e hetimit administrativ. (ii) Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. (iii) Ndryshimin e vendimit nr. 649, datë 24.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhënë për subjektin e rivlerësimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Taulant Tafa.

7. Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

7.1. *Për pasurinë e paluajtshme të llojit “truall dhe banesë dy kate + bodrum + nënçati”, me sipërfaqe 101 m<sup>2</sup> /kati, me vendndodhje në Elbasan:* Subjekti pretendon se Komisioni ka arritur në përfundim të gabuar se nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për ndërtimin e saj duke vlerësuar se koha e ndërtimit është fundi i vitit 2003. Subjekti pretendon se, duke vendosur vitin 2003 si kohën në të cilën ka përfunduar ndërtimi e, për pasojë, edhe kohën në të cilën është krijuar dhe shlyer detyrimi ndaj sipërmarrësit, në analizën financiare Komisioni nuk ka përfshirë të ardhurat, si dhe burimet financiare të vitit 2004, përfshirë ndër to edhe kredinë në vlerën 2.000.000 lekë pranë Alpha Bank, por duke e përlllogaritur këtë kredi si shpenzime rikonstruksioni për vitin 2004. Për këtë arsye, vlerësimi i burimeve financiare, sipas tij, duhet të përfshijë edhe vitin 2004 në analizën financiare për ekzistencën e burimeve të mjaftueshme për ndërtimin e kësaj pasurie, duke përfshirë dhe kredinë bankare në vlerën 2.000.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ky arsyetim provon jo vetëm që kishte burime të mjaftueshme financiare për ndërtimin e objektit, por edhe se deklarimet e tij janë të plota në raport me këto burime dhe vlerën e objektit të ndërtuar.

7.2. *Për pasurinë e paluajtshme të llojit “bodrum”, me sipërfaqe 194 m<sup>2</sup>, të ndodhur në qytetin e Elbasanit:* Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni duhet: (i) të merrte në konsideratë se pagesa e pjesës takuese në shumën 7.000.000 lekë, nuk është paguar sipas modaliteteve të përcaktuara në kontratë, por është paguar shuma 6.000.000 lekë, me nënshkrimin e kontratës në datën 28.02.2005 dhe shuma 1.000.000 lekë, pas marrjes së kredisë në “Alpha Bank” ShA, në datën 21.04.2005; (ii) të riçelte hetimin dhe të thellonte hetimet mbi mundësinë financiare të huadhënësit D. D., për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij për dhënien e huasë në vitin 2005, shumën prej 6.000.000 lekësh; (iii) të përfshinte në analizë të ardhurat nga kredia e marrë në Alpha Bank ShA, në datën 21.04.2005.

7.3. Lidhur me konkluzionin e Komisionit mbi konfliktin e interesit me z. P. K., i cili është administratori i shoqërisë ndërtuese të pasurisë së subjektit “banesë dy kate + bodrum + nënçati” dhe “bodrum”, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk gjendej në kushtet e neneve 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim “K.Pr.Civile”), pasi çështja e gjykuar prej tij, me palë të paditur shtetasin në fjalë (në dhomë këshillimi), nuk prodhon gjendjen e konfliktit të interesit pasi nuk rezultuan të provuara kriteret që përcaktojnë këto dispozita.

8. *Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës,* paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

8.1. Përfundimet e arritura nga Komisioni në lidhje me kriterin e pastërtisë së figurës, janë rezultat i interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit nr. 84/2016, pasi, sipas subjektit, vendimet e dhëna prej tij në lidhje me përmbajtjen apo zbatimin e ligjit, duhet të ishin vlerësuar nga Komisioni në kriterin e aftësisë profesionale, dhe jo në kuadër të neneve 37, 38 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016.

9. *Lidhur me vlerësimin tërësor të të tria kriterëve:* Subjekti ka pretenduar se problematikat e konstatuara nga Komisioni, nuk arrijnë deri në atë nivel, në mënyrë që të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

##### a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra për rivlerësimin e subjektit Taulant Tafa, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

##### b) Legjitimimi i ankuesit

11. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

##### c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 649, datë 24.04.2023, të Komisionit, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

13. Në përfundim, trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit të fashikullit të administruar gjatë këtij procesi në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Në referencë të dispozitës së sipërcituar, trupi gjykues çmoi gjithashtu se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit nuk është i nevojshëm, dhe se lidhur me këtë çështje mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

*B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit nga Komisioni dhe çështje të zbatimit të legjislacionit*

14. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka cenuar nenin 8 të KEDNj-së pasi në rastin objekt gjykimi, masa e dhënë për shkarkimin e tij, nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Sipas subjektit të rivlerësimit, duke pasur parasysh që neni 58 i ligjit nr. 84/2016, përcakton se rezultatet e vetme të mundshme të procesit të verifikimit janë: (a) konfirmimi në detyrë; (b) pezullimi nga detyra për një periudhë njëvjeçare; dhe (c) shkarkimi nga detyra – institucioneve të rivlerësimit u jepet mundësi e kufizuar për të balancuar interesat publikë dhe individualë të konkurruar në dritën e secilit rast individual. Subjekti u shpreh se, ndonëse ligji nr. 84/2016 parashikon se gjatë hetimit administrativ duhet të respektohet parimi i proporcionalitetit, ai nuk përmban rregulla, në bazë të të cilave të sigurohet që shkarkimi i subjektit të rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, do të zbatohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
15. Në shqyrtim të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vlerësoi fillimisht se analiza lidhur me respektimin ose jo të parimit të proporcionalitetit në dhënien e masës së shkarkimit të subjektit nga detyra, është objekt kontrolli nga ana e Kolegjit në shqyrtimin e shkaqeve të ankimit që kundërshtojnë konkluzionet e Komisionit lidhur me themelin e çështjes, të cilat kanë çuar në marrjen e vendimit për shkarkimin e subjektit. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues çmoi se, sa kohë pretendimi për cenim të nenit 8 të KEDNj-së është ngritur nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të moszbatimit të parimit të proporcionalitetit në lidhje me masën e shkarkimit nga detyra, si pasojë e kufizimeve që prodhojnë dispozitat e ligjit nr. 84/2016, ky pretendim gjendet i pabazuar në ligj. Ky konkluzion i trupit gjykues mbështetet në faktin që dispozitat e ligjit nr. 84/2016 i janë nënshtruar edhe procesit të kontrollit të kushtetutshmërisë, vlerësuar sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.01.2017. Gjithashtu, rezultoi se edhe GjEDNj-ja, në vendimin e saj në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë, në shqyrtimin e pretendimeve të kërkuases, të ngjashme me këto të subjektit të rivlerësimit, ka vlerësuar se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me masën e shkarkimit nga detyra të kërkuases. GjEDNj-ja<sup>9</sup> është shprehur: “[...] Në të vërtetë, ligji nr. 84/2016 parashikon dy lloje sanksionesh disiplinore: shkarkimin nga detyra ose pezullim me detyrimin për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm. Gjykata ka konsideruar, ndër të

---

<sup>9</sup>Shih Oleksandr Volkov, paragrafi 182: “Në lidhje me këtë, gjykata duhet të theksojë se ligji për Gjykatën Kushtetuese parashikon një hierarki më të hollësishme sanksionesh disiplinore, siç përshkruhet në paragrafin 20 më lart, i cili vendoset në përfundim të procesit të zakonshëm disiplinor. Sidoqoftë, procesi i rivlerësimit ka natyrë sui generis, me gjithë ngjashmëritë që duket se ka me proceset e zakonshme disiplinore. Ai është miratuar në përgjigje të pranisë së perceptuar të përhapur të korrupsionit në sistemin e drejtësisë, në mënyrë që të largojë elementet e korruptuara dhe të ruajë pjesën e shëndetshme të sistemit. Në rrethanat e jashtëzakonshme që i paraprijnë miratimit të ligjit nr. 84/2016, siç theksohet, gjithashtu, në paragrafët 391, 392 dhe 404 më lart, gjykata konstaton se është në përputhje me frymën e procesit të rivlerësimit që të ketë një shkallë më të kufizuar sanksionesh, në rast se një person nuk arrin të përmbushë një nga tri kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 84/2016. [...]”.

*tjera, se mungesa e një shkalle të përshtatshme sanksionesh për shkelje disiplinore mund të jetë në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit.*

### **C. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimi i trupit gjykues**

16. *Lidhur me pasurinë e paluajjtshme të llojit “banesë dy kate + bodrum + nënçati 101 m<sup>2</sup> /kati”, me vendndodhje Elbasan, Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] subjekti i rivlerësimit, për ndërtimin e banesës dy kate + bodrum + nënçati deri në datën 31.12.2003, ka balancë negative prej (-) 1.613.573 lekësh. Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e banesës së deklaruar në deklaratën vetting në pronësi të tij prej dy kate + bodrum + nënçati, me sip. 101 m<sup>2</sup>/kati, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*
17. *Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e mësipërm të Komisionit, duke ngritur pretendime në drejtim të kohës së ndërtimit të pasurisë, si dhe të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për përballimin e tyre. Sipas subjektit, Komisioni, në kryerjen e analizës lidhur me këtë pasuri, duhet të kishte mbajtur në konsideratë se ndërtimi ka përfunduar në vitin 2004 dhe, rrjedhimisht, duhet të kishte përfshirë si një ndër burimet për ndërtimin e banesës edhe kredinë e marrë në këtë vit.*
18. *Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, nga analizimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, rezultoi se në deklaratën e pasurisë vetting, ai ka deklaruar: Kam në pronësi banesë dy kate + bodrum + nënçati, dhe truallin në të cilin është ndërtuar banesa. Sipërfaqja e truallit është 200 m<sup>2</sup>, nga e cila 101 m<sup>2</sup> është banesë e regjistruar në ZVRPP Elbasan, me nr. pasurie {\*\*\*}, Zona Kadastrale {\*\*\*}, sipas vërtetimit hipotekor, datë 31.03.2015. Këtë pasuri e kam përfituar me trashëgimi ligjore në masën 1/3, si trashëgimtar ligjor i babait, të ndjerit Dh. T. dhe në masën 2/3 me aktin e dhurimit, datë 30.09.2011, sipas të cilit dy trashëgimtarët ligjore të të ndjerit, nëna A. T. dhe motra A. T., më kanë dhuruar mua pjesën takuese të trashëgimisë ligjore. Vlera e banesës, në momentin e ndërtimit, ka qenë rreth 3.500.000 lekë. Pjesa takuese 100%. Pasuria e lartpërmendur është krijuar nga babai në këtë mënyrë: a) Pasuria e llojit truall është 200 m<sup>2</sup>, në të cilin ndodhet banesa, është përfituar nga Dh. T. me anë të trashëgimisë ligjore, si një ndër trashëgimtarët ligjorë të babait të tij, V. T., në emër të të cilit ka qenë i regjistruar i gjithë trualli me akt pronësie të vitit 1933. Midis trashëgimtareve ligjorë të të ndjerit V. T. (Dh. T., L. T. dhe F. T.) është bërë pjesëtimi vullnetar i truallit më datë 15/01/2002, ku pjesa takuese e babait Dh. T. ishte 200 m<sup>2</sup> truall, në bazë të të cilit është bërë dhe regjistrimi më vete i pronësisë së truallit më datë 30.01.2002. b) Pasuria e llojit ndërtesë është krijuar në bazë të lejes së ndërtimit nr. {\*\*\*}, datë 30.04.2002, lëshuar nga KRRT Bashkia Elbasan, në emër të babait Dh. T., ndërsa më datë 07.06.2004, është dhënë miratimi i lejes së shfrytëzimit. Sipas preventivit të paraqitur nga subjekti ndërtues dhe miratuar nga KRRT bashkia Elbasan, vlera e ndërtimit (sipas çmimeve të kohës) ishte në shumën 3.007.513 (tre milionë e shtatë mijë e pesëqind e trembëdhjetë) lekë, pasqyruar dhe në aktet e lëshuara nga Bashkia Elbasan. Shënim: Në dijeninë time, janë kryer dhe shpenzime mbi vlerën e preventivit, rreth 500.000 (pesëqind mijë) lekë.*

18.1. Ndërsa, në deklaratën për herë të parë të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Një banesë private në Elbasan, në vlerën 3,3 milionë lekë, në pronësi në masën 1/3, në Elbasan, pa regjistruar. Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: puna e prindërve; puna ime; pjesëtimi i pasurisë (truall i trashëguar) midis babait Dh. dhe vëllezërve L. dhe F. T..*

18.2. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Në momentin që kam marrë detyrën (në vitin 1993), pronar i banesës ekzistuese, përfunduar në vitin 2004, ka qenë babai. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar: Të ardhurat e krijuara dhe që kanë shërbyer pjesërisht si burim financiar për ndërtimin e banesës 2 kate + bodrum + çati, në Elbasan, janë krijuar nga të ardhurat e prindërve dhe të ardhurat e mia. Kjo për faktin se edhe gjatë kësaj periudhe kam banuar dhe jetuar së bashku me prindërit (sipas certifikatës familjare gjendja e vitit 2003).*

18.3. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, në datën 07.01.2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Banesa ka filluar të ndërtohet, me sa mbaj mend, në vitin 1999 dhe ka mbaruar në vitin 2003.*

19. Referuar dokumentacionit të ndodhur në fashikujt e Komisionit, u konstatua se në datën 30.04.2002, në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, është dhënë leja e ndërtimit të objektit 2 kate + bodrum + nënçati, me afat deri në datën 08.05.2003<sup>10</sup>. Në procesverbalin e kolaudimit të objektit 2 kate + bodrum + nënçati, të datës 08.04.2004, afati i ndërtimit specifikohet deri në datën 08.05.2003 dhe vlera e ndërtimit prej 3.149.982 lekësh. Me vërtetimin e datës 07.06.2004, Drejtoria e Urbanistikës në Bashkinë Elbasan ka konfirmuar se objekti 2 kate + bodrum + nënçati, për banesë, është përfunduar konform projektit dhe kushteve urbanistike të miratuara sipas vendimit, datë 30.04.2002, të KKRT-së. Leja e shfrytëzimit është miratuar në datën 07.06.2004. Pasuria e paluajtshme me nr. {\*\*\*}, z. k. {\*\*\*}, me sipërfaqe truall 200 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 2 kate + bodrum + nënçati, me sipërfaqe 101 m<sup>2</sup>/kat, është regjistruar në regjistrin hipotekor në datën 14.6.2004, në emër të të ndjerit Dh. T..
20. Komisioni është shprehur në vendim se: *Në deklaratën e interesave private të vitit 2003, të dorëzuar në datën 18.03.2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo pasuri është ndërtuar deri në datën 31.12.2003. Trupi gjykues vëren se Komisioni ka bërë një interpretim të deklaramit të subjektit në deklaratën e vitit 2003, duke konsideruar se, ndonëse ajo është dorëzuar në datën 18.03.2004, ajo përbën një pasqyrë të pasurive të subjektit deri në datën 31.12.2003.*
21. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit për të konsideruar si moment të përfundimit të ndërtimit datën e lëshimit të lejes së shfrytëzimit, nuk gjen mbështetje të plotë në kuadrin ligjor të kohës. Në referim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, procedura e realizimit të një objekti ndërtimor përbën, përveçse një proces teknik, njëkohësisht edhe një proces administrativ që fillon me pajisjen me dokumentacionin e nevojshëm, ndër to dhe leja e ndërtimit, vijon me kryerjen e punimeve sipas projektit të miratuar dhe përfundon

---

<sup>10</sup> Truall ku është ndërtuar kjo banesë, është përfutuar me aktin e pjesëtimit vullnetar, datë 15.01.2002, nga babai i subjektit të rivlerësimit, i ndjeri Dh. T..

me verifikimin e përputhshmërisë së objektit të ndërtuar me dokumentacionin teknik e ligjor, duke mundësuar më pas lëshimin e lejes së shfrytëzimit. Nga interpretimi sistematik i dispozitave të këtij ligji, rezulton se leja e shfrytëzimit nuk përbën aktin që materializon përfundimin fizik të ndërtimit, por një akt administrativ që konstaton se objekti është ndërtuar në përputhje me lejen e ndërtimit dhe standardet teknike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, duke e bërë atë të përdorshëm dhe të regjistrueshëm në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme. Për rrjedhojë, ekzistenca e një lejeje shfrytëzimi provon se në datën e lëshimit të saj, objekti ka qenë i përfunduar, por nuk provon domosdoshmërisht se punimet ndërtimore janë përfunduar pikërisht në atë datë. Në këtë kuptim, data e lëshimit të lejes së shfrytëzimit nuk përputhet me datën reale të përfundimit të punimeve (investimit), pasi ndërmjet përfundimit faktik të punimeve dhe përfundimit të procedurave administrative përkatëse, mund të ekzistojë një interval kohor, i cili varet nga verifikimet teknike, kontrolli i dokumentacionit dhe procedurat administrative të ndjekura nga organet kompetente.

22. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se, për qëllime të analizës financiare dhe të verifikimit të burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë, momenti i përfundimit të investimit duhet të përcaktohet mbi bazën e një vlerësimi tërësor të provave të administruara në dosje.

Në kuadër të kësaj analize, trupi gjykues gjen me vend të nënvizojë se: (i) deklarimi i pasurisë objekt kontrolli, si vendbanim nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën për herë të parë, dorëzuar në vitin 2004; (ii) mosdeklarimi i ndonjë detyrimi financiar të mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese lexuar në harmoni me mosdeklarimin në deklaratën pasuese të interesave privatë periodikë të vitit 2004, të shlyerjes së ndonjë detyrimi të mbetur ndaj së njëjtës shoqërie; (iii) parashikimet e kontratës së kredisë sipas të cilave rezultoi e provuar se ajo është marrë dhe përdorur për rikonstruksion banese; (iv) mungesa e dokumentacionit financiar (situacione) që provojnë përfundimin e punimeve; si dhe (v) fakti mbi deklarimin e shpenzimeve të mobilimit të deklaruara nga subjekti si të kryera në vitin 2003, provojnë se në vitin 2003 banesa ka qenë e përfunduar dhe kishte filluar mobilimi i saj – janë rrethana të cilat jo vetëm vijnë në kundërshtim me sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit për momentin e përfundimit të ndërtimit, por të vlerësuara në tërësi, krijuan bindjen te trupi gjykues se qëndrimi i Komisionit mbi kohëzgjatjen e ndërtimit dhe kryerjen e investimit për këtë qëllim, në periudhën 2002 – 2003, është i drejtë.

23. Sa i takon çështjes së burimeve të deklaruara të të ardhurave dhe mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit, për ndërtimin e pasurisë objekt kontrolli, sikurse është përmendur më sipër, Komisioni ka konkluduar se, për ndërtimin e pasurisë banesë dy kate + bodrum + nënçati, me sipërfaqe 101 m<sup>2</sup>/kati, deri në datën 31.12.2003, subjekti i rivlerësimit ka balancë negative prej (-) 1.613.573 lekësh, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
24. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka ngritur të njëjtat pretendime me ato të paraqitura në Komision pas kalimit të barrës së provës, duke parashtruar se Komisioni duhet të kishte konsideruar në analizën financiare si burim për krijimin e kësaj pasurie, edhe kredinë bankare me Alpha Bank ShA, në shumën 2.000.000 lekë, të marrë sipas kontratës *nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë*

24.09.2004. Subjekti e lidh këtë pretendim me kohën e përfundimit të ndërtimit të banesës, duke ripërsëritur se ndërtimi ka përfunduar në vitin 2004. Gjithashtu, sipas subjektit, ndërtimi i objektit nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, është një nga rastet tipike të kontratës së sipërmarrjes, çka nënkupton që subjekti i rivlerësimit, për sa kohë nuk ishte lëshuar leja e shfrytëzimit nga Bashkia Elbasan (lëshuar më 07.04.2004) dhe nuk ishte kryer regjistrimi i objektit në ZVRPP (regjistruar më 14.04.2004), nuk kishte detyrimin që të përmbushte elementin e pagesës së plotë të çmimit të kontratës.

25. Nga verifikimi i dokumentacionit të fashikullit të çështjes, trupi gjykues vëren se në deklaratën *vetting*, si burim krijimi për ndërtimin e pasurisë, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: *Pasuria e llojit truall është përfitur nga babai Dh. T. me trashëgimi ligjore. Pasuria e llojit ndërtesë është krijuar nga babai Dh. T. pjesërisht nga të ardhurat familjare dhe pjesa tjetër nga kredia e marrë në bankën Alpha Bank, dega Elbasan [...]. Veç të ardhurave familjare të krijuara nga babai, nëna dhe paga ime, duke qenë se babai nuk kishte tërë paratë e nevojshme për ndërtimin dhe përfundimin e banesës, nga ana ime është marrë kredi në shumën 2.000.000 (dy milionë) lekë pranë Alpha Bank ShA, në Elbasan, nën dorëzaninë e prindërve. Për këtë, është lidhur kontrata nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.09.2004, ku nga banka është tërhequr tërë shuma e kredisë për të kryer pagesat e prapambetura ndaj subjektit ndërtues. Kredia është shlyer rregullisht sipas detyrimeve dhe periudhës së përcaktuar në kontratë dhe momentalisht nuk kemi detyrime ndaj bankës, sipas dhe vërtetimit të lëshuar nga Alpha Bank, dega Elbasan [...].*
26. Në deklarin e interesave privatë për herë të parë, dorëzuar në ILDKPKI në datën 18.03.2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për ndërtimin e pasurisë në analizë: (i) të ardhurat nga puna e prindërve; dhe (ii) të ardhurat nga puna e tij.
27. Në procesverbalin e mbajtur në datën 07.01.2015, në ILDKPKI, në përgjigje të pyetjes mbi burimin e krijimit të shtëpisë së banimit në Elbasan, subjekti ka deklaruar: *Burim krijimi janë kursimet familjare dhe puna e babait. Në vitin 1999, me sa mbaj mend, në emrin tim kam marrë edhe një kredi bankare me periudhë 5-vjeçare.*
28. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar: *Të ardhurat e krijuara dhe që kanë shërbyer pjesërisht si burim financiar për ndërtimin e banesës 2 kate + bodrum + çati, në Elbasan, janë krijuar nga të ardhurat e prindërve dhe të ardhurat e mia. Kjo për faktin se edhe gjatë kësaj periudhe, kam banuar dhe jetuar së bashku me prindërit (sipas certifikatës familjare gjendja e vitit 2003).*
29. *Lidhur me të ardhurat nga puna e prindërve, nga kontrolli i ushtruar ndaj analizës financiare të kryer nga Komisioni nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues konstatoi se ato janë përfshirë në mënyrë të saktë, në përputhje me dokumentacionin e administruar në fashikullin e çështjes.*
30. *Lidhur me kredinë e marrë në vitin 2004, në shumën 2.000.000 lekë, të deklaruar nga subjekti në deklaratën vetting, si një ndër burimet për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues*

konstatoi se në datën 24.9.2004, subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga Alpha Bank, kredinë në shumën 2.000.000 lekë, me afat 5-vjeçar dhe objekt kreditimi rikonstrukcion banese.

31. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar: [...] *Duke qenë se familjarisht nuk disponim shumën që nevojitet për ndërtimin e banesës nga ana e babait Dh. T. dhe subjektit zbatues të ndërtimit (P. K.), është rënë dakord në mënyrë verbale me mirëbesim që shuma totale për ndërtimin e objektit të likuidohet pas kolaudimit e regjistrimit të banesës. Shkaku që kredia në shumën 2.000.000 lekë pranë Alpha Bank, është marrë në datën 24.9.2004, pas përfundimit të banesës (datë 14.6.2004), lidhet me faktin se banka kërkonte vendosjen e një kolaterali, i cili u vendos pikërisht banesa 2 kate + bodrum + çati. Pas miratimit të kredisë, është tërhequr shuma e kredisë prej 2.000.000 lekësh, që ka shërbyer për të likuiduar detyrimet e prapambetura ndaj subjektit zbatues të ndërtimit. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka depozituar në cilësinë e provës, deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep. nr. {\*\*\*} kol., datë 11.04.2022, të shtetasit P. K., administrator dhe ortak i vetëm i subjektit “{\*\*\*}” ShPK, i cili ka konfirmuar dakordësinë verbale/në mirëbesim, për likuidimin e detyrimit, në përfundim të ndërtimit të banesës.*
32. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të fashikullit, trupi gjykues konstaton se nga informacioni i përcjellë nga OTP Bank ShA (ish-Alpha Bank ShA), rezultoi se, sipas kontratës së kredisë së datës 24.09.2004, subjekti ka marrë një kredi në shumën 2.000.000 lekë, me afat 5-vjeçar dhe objekt kreditimi “Rikonstrukcion banese”. Pas disbursimit të vlerës së kredisë në llogari në datën 28.09.2004, subjekti në datën 05.10.2004 ka tërhequr *cash* 1.872.900 lekë. Trupi gjykues vëren se të ardhurat e tërhequra nga subjekti nga llogaria e kredisë, datojnë më 05.10.2004, pas regjistrimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme të pasurisë objekt kontrolli “banesë 2 kate + bodrum + nënçati” në datën 14.06.2004.
33. Trupi gjykues vëren fillimisht se pretendimi i subjektit për likuidimin e detyrimeve në kuadër të kontratës së sipërmarrjes, vetëm pas përfundimit të ndërtimit në vitin 2004, pretendim ky që përveçse rezultoi i paraqitur për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit, u konstatua se bie ndesh me sa më sipër arsyetuar nga trupi gjykues lidhur me kohën e përfundimit të punimeve të ndërtimit.
34. Në lidhje me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep. nr. {\*\*\*} kol., datë 11.04.2022, të shtetasit P. K., administrator dhe ortak i vetëm i subjektit “{\*\*\*}”, trupi gjykues, pasi analizoi deklaratimet e këtij shtetasi, vlerësoi se kjo deklaratë e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ, në mbështetje të pretendimeve të tij, në mungesë të deklaramit nga z. P. K. të kohës së përfitimit të pagesës nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e porositësit, e pashoqëruar me dokumentacion provues lidhur me faktet e deklaruara për likuidim, *në përfundim të ndërtimit, pas marrjes nga subjekti i rivlerësimit të kredisë*, u çmua pa efekt në analizën e kryer nga trupi gjykues lidhur me vlerësimin e këtij burimi.
35. Trupi gjykues, në vlerësim të kësaj situatë faktike, ku subjekti i rivlerësimit pretendon si një ndër burimet e financimit të ndërtimit, kredinë e marrë pas përfundimit të punimeve ndërtimit, në konsideratë edhe të rrethanave faktike të rezultuara nga hetimi administrativ, të tilla si: (i) procesverbali i kolaudimit i datës 08.04.2004, ku afati i ndërtimit është specifikuar deri në datën 08.05.2003; (ii) deklarata për herë të parë ku subjekti ka deklaruar vlerën e plotë të ndërtimit prej

3.300.000 lekësh, pa deklaruar detyrime ndaj shoqërisë ndërtuese të palikuiduara (iv) procesverbali i mbajtur në ILDKPKI në datën 07.01.2015, ku subjekti ka deklaruar përfundimin e ndërtimit në vitin 2003; (iv) distanca kohore mes datës së regjistrimit të pasurisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe datës së disbursimit të kredisë së pretenduar për pagesën e një pjese të punimeve të ndërtimit, vlerësuar në raport edhe me qëllimin e marrjes së saj për *rikonstrukcion banese*; (v) mungesa e dokumenteve që provojnë momentin kohor të transferimit të fondeve të kredisë të ndërtuesi, apo përdorimin e tyre për ndërtimin – arriti në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se të ardhurat nga kredia kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, është i pabazuar në fakte dhe në prova.

**35.1.** Gjithashtu, trupi gjykues e gjeti të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, nëse do të merreshin në konsideratë në mënyrë të përmbledhur të gjitha të ardhurat e realizuara prej tij ndër vite dhe nga kjo shumë do të zbriteshin shpenzimet totale të kryera, si dhe vlera e pasurive të krijuara, ai do të rezultonte me bilanc financiar pozitiv. Në këtë drejtim, trupi gjykues çmon se metodologjia e analizës financiare e zbatuar në procesin e rivlerësimit, nuk mbështetet në një vlerësim kumulativ të burimeve financiare përgjatë gjithë periudhës së jetës së subjektit, por në verifikimin e gjendjes financiare për secilin vit kalendarik dhe për çdo moment të krijimit të pasurisë apo kryerjes së shpenzimeve përkatëse. Vetëm në këtë mënyrë mund të verifikohet nëse subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme për krijimin e pasurive të deklaruara në vitin përkatës të krijimit të tyre, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të njësisë familjare, duke garantuar një vlerësim objektiv dhe të plotë të saktësisë së deklarimeve dhe ligjshmërisë së burimeve financiare. Pretendimi i subjektit se mungesat financiare të konstatuara, janë mbuluar me të ardhura të realizuara në periudha të mëvonshme, do të binte ndesh me qëllimin e procesit të rivlerësimit dhe me standardin e konsoliduar të jurisprudencës së Kolegjit, sipas së cilës ekzistenca e burimeve të ligjshme duhet të provohet dhe të rezultojë e disponueshme në kohën e krijimit të pasurisë ose kryerjes së shpenzimit përkatës. Në këto kushte, pretendimi i subjektit nuk mund të merret në konsideratë si argument që përmbys gjetjet e analizës financiare të kryer nga Komisioni.

**35.2.** Në përfundim, bazuar në konkluzionet e mësipërme, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni lidhur me verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt kontrolli sipas këtij shkak ankimi, duke e gjetur atë të saktë, trupi gjykues arriti në të njëjtin konkluzion si Komisioni, se subjekti i rivlerësimit, edhe pas kontrollit të ushtruar në Kolegj, rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për ndërtimin e pasurisë së paluajtshme “truall dhe banesë dy kate + bodrum + nënçati”, të ndodhur në qytetin e Elbasanit, në shumën e 1.613.573 lekëve, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5 shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**36.** *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “bodrum” me sipërfaqe 194 m<sup>2</sup>, në vlerën 14.000.000 lekë, për të cilën Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] nuk ekziston asnjë shkak ligjor, që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratën noteriale të lidhur mes palëve, lidhur me kohën e pagimit të çmimit prej 14.000.000 lekësh për blerjen e kësaj pasurie të*

*paluajtshme në datën 28.2.2005, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë konkluzion si rezultat i vlerësimit të gabuar të provave të marra gjatë shqyrtimit administrativ.*

37. Në mbështetje të këtij shkakut ankimi, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, për përcaktimin e momentit kohor të likuidimit të çmimit për blerjen e kësaj pasurie, Komisioni duhet t'i ishte referuar: a) kontratës së shitblerjes së datës 28.02.2005, në të cilën përcaktohet se pagesa e çmimit është bërë jashtë zyrës noteriale; b) deklarimeve të subjektit për pagesën e shumës 9.000.000 lekë në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe pagesën e pjesës së mbetur prej 5.000.000 lekësh pas marrjes së kredisë në Alpha Bank ShA, në datën 21.04.2005; dhe c) deklaratës noteriale të shitësit të pasurisë, të datës 11.04.2022, i cili ka konfirmuar se pagesa është bërë pjesërisht në datën 28.02.2005, në vlerën 9.000.000 lekë dhe pjesa e mbetur prej 5.000.000 lekësh është shlyer gradualisht pas marrjes së kredisë në Alpha Bank ShA.
38. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, nga verifikimi i akteve të fashikullit të çështjes trupi gjykues konstaton si më poshtë.
39. Kjo pasuri nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi, duke qenë se është shitur në vitin 2008, nuk ishte objekt deklarimi. Në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit “bodrum” me sipërfaqe 194 m<sup>2</sup>, me pjesë takuese 1/12, dhe vlerë 14.000.000 lekë, të krijuar në datën 28.02.2005, pa deklaruar burimet e krijimit të kësaj pasurie.
40. Nga aktet në fashikujt e dërguar nga Komisioni, rezultoi se me kontratën e shitblerjes me nr. {\*\*\*}, datë 28.2.2005, subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi D. D. kanë blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, pasurinë e llojit “bodrum” me sip. 194 m<sup>2</sup>, e ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, pallati nr. {\*\*\*}, regjistruar me nr. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, zk. {\*\*\*}. Në këtë kontratë, është përcaktuar se çmimi i blerjes prej 14.000.000 lekësh, është likuiduar tërësisht dhe jashtë zyrës noteriale.
41. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se çmimi prej 14.000.000 lekësh, për blerjen e pasurisë së llojit “bodrum”, nuk është likuiduar sipas kontratës. Subjekti ka shpjeguar se, së bashku me z. D. D., në pamundësi për të plotësuar shumën prej 14.000.000 lekësh, kishin rënë dakord me shitësin P. K. (në mirëbesim, për shkak të marrëdhënies miqësore/familjare), për pagesën e shumës prej 9.000.000 lekësh, *cash* nga z. D. D., ditën e nënshkrimit të kontratës, ndërsa diferenca prej 5.000.000 lekësh do të shlyhej pas marrjes së kredisë bankare. Subjekti ka deklaruar se, nga ana e tij, nuk është kryer asnjë investim në këtë pasuri. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka paraqitur pranë Komisionit, në cilësinë e provës, një deklaratë noteriale të datës 11.04.2022, të z. P. K., i cili ka deklaruar se: *Në vitin 2004 – 2005, kam ndërtuar pallatin ku ndodhej edhe një pjesë e bodrumit me sipërfaqe 194 m<sup>2</sup>, të cilin ua kam shitur shtetasve Taulant Tafa dhe D. D. kundrejt shumës 14.000.000 lekë. Në momentin e hartimit të kontratës së shitjes, nga blerësit është likuiduar shuma 9.000.000 lekë dhe, pas disa muajsh pas marrjes së kredisë, kanë shlyer gradualisht të gjithë shumën.*

42. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 07.01.2015, subjekti ka deklaruar: *Kam paguar 1.000.000 lekë nga kredia e marrë, pjesën tjetër të kredisë e ka shfrytëzuar z. D. për rregullimin e bodrumit, të cilin e ktheu në lokal.*
43. Lidhur me marrëdhënien kontraktuale të krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, sipas përmbajtjes së kontratës së shitblerjes me nr. {\*\*\*}, datë 28.02.2005, rezultoi se blerësit (subjekti i rivlerësimit dhe z. D. D.), kanë likuiduar çmimin e blerjes prej 14.000.000 lekësh, tërësisht jashtë zyrës noteriale, pra, përpara nënshkrimit të kontratës te noteri publik. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues, në kuadër edhe të parashikimeve të nenit 690 të Kodit Civil<sup>11</sup>, vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për pagesën e kështit prej 9.000.000 lekësh për blerjen e pasurisë “bodrum” në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe pagesën e pjesës së mbetur prej 5.000.000 lekësh pas marrjes së kredisë në “Alpha Bank” ShA, në datën 21.04.2005, janë të pabazuara në fakte pasi rezultuan se vijnë në kundërshtim me përcaktimet e kontratës së shitblerjes lidhur me pagesën e çmimit të shitblerjes.
44. Në këtë kontekst, deklaratimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit dhe ato në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 07.01.2015, si më sipër parashtruar, vijnë ndesh me të dhënat e kontratës së shitblerjes mbi mënyrën e pagesës së çmimit të blerjes së pasurisë “bodrum”. Këto deklarime u gjetën në kontradiksion edhe me të dhënat e deklaratës periodike të vitit 2004, në të cilën nuk rezultoi i deklaruar ndonjë detyrim i mbartur ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, deklaratë kjo e cila, në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përbën provë në këtë proces.
- *Analiza e burimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie dhe mundësia financiare*
45. Lidhur me burimin e ligjshëm financiar për blerjen e pjesës takuese në pasurinë e llojit “bodrum”, trupi gjykues vëren se Komisioni ka arritur në përfundimin se: *Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të pjesës takuese në pasurinë bodrum, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Këtë konkluzion, Komisioni duket se e ka arritur pasi ka arsyetuar se: [...] subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të huasë, marrë nga shtetasi D. D., në shumën 6.000.000 lekë dhe ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*
46. Në kundërshtimin e këtij konkluzioni, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se pagesa e pjesës takuese për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 7.000.000 lekë, është kryer pjesërisht në momentin e nënshkrimit të kontratës në datën 28.02.2005, në shumën 6.000.000 lekë, dhe pjesa e mbetur në

---

<sup>11</sup> Në të cilin përcaktohet shprehimisht se: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të ndryshohet me pëlqimin e palëve ose për shkaqet e parashikuara me ligj. Kontrata e përpiluar nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklaratimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre”.*

shumën prej 1.000.000 lekësh, në momentin e marrjes së kredisë bankare në vlerën 5.000.000 lekë në Alpha Bank, në datën 21.04.2005. Në kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit lidhur me burimet e ligjshme të huadhënësit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, për të verifikuar mundësinë financiare të huadhënësit D. D., Komisioni duhet të kishte marrë në konsideratë deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}, datë 10.04.2023, të shtetasit Xh. Sh., në të cilën ky shtetas ka deklaruar se, në cilësinë e familjarit, i ka dhënë hua z. D. në vitin 2005, shumën prej 6.000.000 lekësh<sup>12</sup>, e cila, në dijeninë e tij, është përdorur për blerjen e pasurisë “bodrum” me sipërfaqe prej 194 m<sup>2</sup> të ndodhur në Elbasan.

47. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti nuk ka deklaruar as blerjen dhe as investimet e kryera në pasurinë “bodrum”, duke qenë se kjo pasuri rezulton të mos ketë qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit në datën e dorëzimit të kësaj deklaratë, si pasojë e shitjes në datën 27.05.2008. Rezultoi gjithashtu që pjesë e kësaj deklarate, nuk ishin bërë as të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie.
48. Në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë për vitin 2004, subjekti, ndonëse ka deklaruar blerjen e pasurisë së llojit “bodrum” me sip. 194 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, në shumën 14.000.000 lekë, me pjesë takuese ½ (7.000.000 lekë), nuk rezulton të ketë deklaruar burimin e të ardhurave të pjesës së tij takuese. Në rubrikën që u përket “Detyrimeve financiare”, ka deklaruar një hua në shumën 6.000.000 lekë, me afat 3-vjeçar, pa interes, të marrë nga shtetasi D. D. në datën 03.03.2005, pa dhënë shpjegime të tjera lidhur me arsyet e kësaj huaje.
49. Nga shqyrtimi i akteve në fashikujt e dërguar nga Komisioni, rezultoi se, në bazë të kontratës së huadhënies me nr. {\*\*\*}, datë 03.03.2005, subjekti ka marrë një hua pa interes, në shumën 6.000.000 lekë nga shtetasi D. D., për një periudhë 3-vjeçare, me këste kthimi 2.000.000 lekë për çdo vit. Në përgjigje të pyetësorit standard, në lidhje me borxhe të marra nga persona dhe/ose shoqëri private, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se nuk mban mend të ketë marrë ndonjëherë borxh nga ndonjë person apo shoqëri private.
50. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, në lidhje me kohën dhe mënyrën e pagesës së çmimit të blerjes së bodrumit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *Në kontratën e shitblerjes së pasurisë së llojit “bodrum”, në datën 28.2.2005, kemi përcaktuar se vlera e blerjes është 14.000.000 lekë, të cilat janë paguar jashtë zyrës noteriale në gjendje cash. Në të vërtetë, shuma është shlyer duke ndjekur modalitet të ndryshëm nga sa kemi përcaktuar në kontratën e shitjes. Duke qenë se as unë dhe as bashkëpronari tjetër D. D., nuk plotësonim shumën në fjalë, nuk kemi mundur të paguanim shumën e plotë prej 14.000.000 lekësh, atëherë kemi rënë dakord me shitësin P. K. që diferenca prej 5.000.000 lekësh të shlyhej pas marrjes së kredisë bankare [...]. Nga ana ime, nuk është marrë asnjëherë cash apo me bankë shuma prej 6.000.000 lekësh, pasi shuma prej 6.000.000 lekësh i*

<sup>12</sup> Në këtë deklaratë noteriale, z. Sh. ka deklaruar se, pas kthimit nga Italia në vitin 2004, z. D. ka qenë i punësuar pranë shoqërisë së tij tregtare, pavarësisht faktit që nuk është deklaruar si i punësuar në administratën tatimore dhe/apo në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

*përket një pjese të paguar për bodrumin nga shtetasi D. D., të cilën ia njoha më pas me kontratë huaje në datën 03.03.2005.*

51. Komisioni, bazuar në faktin se sipas kontratës së huasë së datës 03.03.2005, subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur kanë konfirmuar marrëdhënien e huasë, bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i ka kërkuar subjektit të provonte ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua nga z. D. e të përdorur si burim për blerjen prej tij të pjesës takuese prej ½ të bodrumit me sip. 194 m<sup>2</sup>, në Elbasan.
52. Lidhur me mundësinë financiare të huadhënësit, z. D., subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni, por edhe në ankimin e paraqitur në Kolegj, ka pretenduar se për periudhën përpara vitit 2005, për shkak të punësimit informal në Itali të z. D., gjendej në pamundësi objektive për të provuar me dokumentacion ligjor të ardhurat e tij. Ndërsa, në lidhje me të ardhurat e realizuara nga z. D. pas vitit 2005, subjekti ka deklaruar se ai kishte bashkëpunuar me z. Xh. Sh., në shoqërinë tregtare me aktivitet “grumbullim të bimëve mjekësore”, e themeluar prej tij që në vitin 1997. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës: (i) një deklaratë noteriale të datës 17.04.2023, në të cilën z. D., ka deklaruar: *Unë i nënshkruari kam qenë në emigrim në shtetin italian, ku kam punuar në mënyrë informale dhe, kur jam kthyer rreth vitit 2004, jam punësuar jo në mënyrë të rregullt ligjore pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me administrator Xh. Sh. me të cilin kam lidhje familjare;* (ii) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.04.2023, të lëshuar nga shtetasi Xh. Sh., në cilësinë e ortakut të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, ku deklarohet se për shkak të marrëdhënies familjare ndërmjet tij dhe shtetasit D. D., i ka dhënë hua këtij të fundit, në vitin 2005, shumën prej 6.000.000 lekësh, e cila është përdorur për blerjen e pasurisë “bodrum” me sipërfaqe prej 194 m<sup>2</sup> në Elbasan; (iii) ekstrakt regjistrimi nga QKB – historiku – të subjektit tregtar “{\*\*\*}”; si dhe (iv) ekstrakt nga QKB-ja për regjistrimin në vitin 2005, të personit fizik D. D., për aktivitetin “Bar-kafe”, aktivitet i cili është çregjistruar në datën 12.01.2006.
53. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit si më sipër, mbi burimin e ligjshëm të huasë, trupi gjykues vëren fillimisht se, në lidhje me të ardhurat e pretenduara si të realizuara për vitin 2005, nga personi fizik “D. D.”, gjatë hetimit të kryer nga Komisioni, ka rezultuar<sup>13</sup> se për këtë vit, personi fizik ka deklaruar xhiro të parashikuar 1.200.000 lekë dhe ka paguar tatim-fitimi të thjeshtuar në shumën 36.000 lekë, shumë kjo e cila edhe nëse do të përlllogaritej e tëra si burim për dhënien e huasë (pa iu zbritur shpenzimet e jetesës), nuk rezulton e mjaftueshme për ta justifikuar atë në shumën e plotë. Ndërsa, në lidhje me punësimin e z. D. para vitit 2005, në emigracion dhe pas kthimit të tij në Shqipëri pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, si pretenduar edhe nga vetë huadhënësi, punësimi i tij ka qenë informal dhe, rrjedhimisht, të ardhurat e pretenduara si të krijuara në këto periudha, nuk plotësojnë standardin e të ardhurës së ligjshme, sipas kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

---

<sup>13</sup> Sipas komunikimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan me anë të shkresës me nr. {\*\*\*} prot., datë 28.06.2022.

54. Në lidhje me pretendimin e subjektit se gjendet në kushtet e pamundësisë së sigurimit të dokumentacionit për të provuar burimet e ligjshme të huadhënësit për të financuar huanë e dhënë, trupi gjykues, në referencë të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nënvizon se në mënyrë që të vërtetohet kjo situatë, subjekti është i detyruar të provojë përpara organeve të rivlerësimit se: (i) dokumenti është zhdukur; (ii) ka humbur; (iii) nuk mund të bëhet përsëri; ose (iv) nuk mund të merret në rrugë tjetër. Në rrethanat konkrete të pohimit nga vetë huadhënësi mbi punësimin informal të tij, pretendimet në drejtim të pamundësisë objektive sipas parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, çmohen pa efekt.
55. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arrin në të njëjtin përfundim si Komisioni se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të huasë së marrë nga shtetasi D. D., në shumën 6.000.000 lekë, në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
- *Lidhur me pagesën e pjesës së mbetur të çmimit për pjesën takuese të pasurisë objekt kontrolli në shumën prej 1.000.000 lekësh, me burim të deklaruar kredinë e marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe z. D. D., në Alpha Bank ShA, në vlerën 5.000.000 lekë:*
56. Trupi gjykues konstaton se Komisioni ka arritur në përfundimin se, referuar dokumentacionit të disponuar, të dhënave për kohën e disbursimit të kredisë, si dhe deklarimit të subjektit në ILDKPKI, në datën 07.01.2015, kjo kredi nuk mund të ketë shërbyer për pagimin e çmimit të kësaj pasurie të paluajtshme nga shtetasi D. D. dhe subjekti i rivlerësimit.
57. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, ka pretenduar në ankim, se ky i fundit, në konsideratë të parashikimit të kontratës së kredisë bankare mbi qëllimin e lidhjes së saj “për blerje njësie lokal”, duhet të kishte arritur në përfundimin për përfshirjen e shumës së kësaj kredie si burim për pagesën e pjesës së mbetur të çmimit të pasurisë objekt kontrolli. Sipas subjektit, Komisioni nuk ka vlerësuar provat e paraqitura prej tij në mbështetje të pretendimit mbi konsiderimin e kredisë bankare si një ndër burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë. Për më tepër, subjekti pretendoi se metodologjia e përdorur nga Komisioni në mospërfshirjen e kredisë si burim pasurie, por ndërkohë ngarkimin e subjektit me 50% të detyrimit për likuidimin e kredisë, është e gabuar.
58. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 07.01.2015, subjekti i rivlerësimit, lidhur me përdorimin e kredisë ka deklaruar: *Kam paguar 1.000.000 lekë nga kredia e marrë, pjesën tjetër e ka shfrytëzuar z. D. për rregullimin e bodrumit të cilin e ktheu në lokal.*
59. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, teksa është pyetur në lidhje me kohën dhe mënyrën e pagesës së çmimit të blerjes, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: “Në kontratën e shitblerjes së pasurisë së llojit “bodrum”, në datën 28.2.2005, kemi përcaktuar se vlera e blerjes është 14.000.000 lekë, të cilat janë paguar jashtë zyrës noteriale, në gjendje *cash*. Në të vërtetë, shuma është shlyer duke ndjekur modalitet të ndryshëm nga sa kemi përcaktuar në kontratën e shitjes. Duke qenë se as unë dhe as bashkëpronari tjetër, z. D., nuk plotësonim shumën në fjalë, nuk kemi mundur të paguanim shumën e plotë prej 14.000.000 lekësh, atëherë kemi rënë

dakord me shitësin, z. K., që diferenca prej 5.000.000 lekësh të shlyhej pas marrjes së kredisë bankare”.

60. Referuar përmbajtjes së kontratës së shitblerjes së pasurisë objekt kontrolli të datës 28.02.2005, subjekti i rivlerësimit dhe z. D. D., në cilësinë e blerësve, dhe shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, në cilësinë e shitësit, kanë përcaktuar se likuidimi i çmimit prej 14.000.000 lekësh, është bërë tërësisht jashtë zyrës noteriale. Ndërkohë që kredia e cila pretendohet si një ndër burimet e likuidimit të çmimit të paguar, rezultoi të jetë disbursuar rreth 2 muaj pas nënshkrimit të kontratës së mësipërme të shitblerjes.
61. Nga analizimi i informacionit dhe të dhënave bankare të përcjella Komisionit nga OTP Bank<sup>14</sup>, rezultoi se me kontratën e kredisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.04.2005, subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit D. D., në cilësinë e bashkëkredimarrësve u është akorduar një kredi nga Alpha Bank, në shumën 5.000.000 lekë<sup>15</sup>, shumë e cila është disbursuar në datën 22.04.2005, në llogarinë e përbashkët të tyre. Nga kjo llogari, për periudhën 22.04.2005 – 11.08.2005, shtetasi D. D. ka kryer 9 tërheqje *cash* në shumën totale prej 4.529.200 lekësh<sup>16</sup>.
62. Në përfundim të sa më sipër konstatuar, në konsideratë të faktit se kredia bankare në shumën 5.000.000 lekë është akorduar dhe disbursuar rreth dy muaj pas kryerjes së transaksionit të blerjes, në të cilin përcaktohej shprehimisht shlyerja totale e çmimit të shitblerjes së bodrumit, vlerësuar kjo në harmoni me mënyrën e tërheqjes së copëzuar të fondeve të kredisë dhe mungesën e provave/indicieve mbi kalimin e pretenduar të fondeve të kredisë te shitësi, si dhe me deklarimin e subjektit në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 07.01.2015, se fondet e kredisë janë përdorur kryesisht për përshtatjen dhe rikonstruksionin e bodrumit me qëllim shndërrimin e tij në lokal nga z. D. D., trupi gjykues arriti në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi përdorimin e shumës prej 1.000.000 lekësh, me burim nga kredia e marrë pranë Alpha Bank, për shlyerjen e pjesës së mbetur të çmimit të pjesës takuese të bodrumit, mbeti në nivel deklarativ, e paprovuar. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit për moskonsiderimin e kredisë bankare si burim për shlyerjen e pagesës në shumën prej 1.000.000 lekësh dhe mospërfshirjen e kësaj shume si të ardhur në analizën financiare, u gjet i drejtë dhe i bazuar.
63. Në këto kushte, nga kontrolli i ushtruar analizës financiare të Komisionit nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, mbi verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për pagesën e pjesës takuese të subjektit prej 50% të çmimit të pasurisë “bodrum” me sipërfaqe 194 m<sup>2</sup>, të blerë në vitin 2005, në vlerën 7.000.000 lekë, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit rezultoi me të njëjtën mungesë të burimeve të ligjshme financiare të konstatuar nga Komisioni për krijimin e

<sup>14</sup> Me shkresën me nr. {\*\*\*}, datë 13.01.2023.

<sup>15</sup> Si barrë hipotekore është vendosur pasuria bodrum me sip. 194 m<sup>2</sup>, e ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, në Elbasan.

<sup>16</sup> Në datën 22.04.2005 z. D. D. ka tërhequr shumën 500.000 lekë; në datën 27.4.2005, z. D. ka tërhequr shumën 469.200 lekë; në datën 09.05.2005, z. D. ka tërhequr shumën 500.000 lekë; në datën 18.05.2005, z. D. ka tërhequr shumën 500.000 lekë; në datën 13.06.2005, z. D. ka tërhequr shumën 1.000.000 lekë; në datën 08.07.2005, z. D. ka tërhequr shumën 300.000 lekë; në datën 20.07.2005, z. D. ka tërhequr shumën 400.000 lekë; në datën 05.08.2005, z. D., ka tërhequr shumën 500.000 lekë; në datën 11.08.2005, z. D. ka tërhequr shumën 360.000 lekë.

kësaj pasurie, në shumën (-) 6.906.367 lekë, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

➤ *Lidhur me të ardhurat në shumën 100.007 euro, nga shitja e pasurisë “bodrum” me sipërfaqe 194 m<sup>2</sup>, në Elbasan:*

64. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e pjesës takuese të pasurisë “bodrum”, trupi gjykues vëren se Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84.2016, si pasojë e mosdeklarimit të tyre në deklaratën e pasurisë *vetting*.
65. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtimin e këtij konkluzioni, ka pretenduar se të ardhurat në shumën prej 100.007 eurosh, të krijuara nga shitja e pjesës takuese të tij në pasurinë “bodrum”, janë shpenzuar për: (i) likuidimin e huasë së datës 03.03.2005, në shumën 6.000.000 lekë; (ii) likuidimin e pjesës së mbetur të kredisë së marrë në Alpha Bank, në datën 21.04.2005, në shumën prej 15.400 eurosh; dhe (iii) diferenca prej rreth 4.000.000 lekësh, është përdorur për shpenzime jetese në periudhën 2008 – 2009, gjatë së cilës subjekti ka qenë i pezulluar nga detyra.
66. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting*, si konstatuar me të drejtë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të ardhura nga shitja e kësaj pasurie. Ndërkohë, në deklaratën periodike të vitit 2008, subjekti rezulton të ketë deklaruar shitjen e kësaj pasurie në shumën 200.000 euro, sipas kontratës së shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.05.2008. Në rubrikën e të ardhurave të së njëjtës deklaratë, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar edhe të ardhurat nga shitja e pjesës takuese prej ½ së pasurisë “bodrum” me sipërfaqe 194 m<sup>2</sup>, në shumën 100.000 euro.
67. Referuar kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.05.2008, subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi D. D. i kanë shitur shtetases H. L., pasurinë e llojit “bodrum”, me sip. 194 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 200.014 euro. Në këtë kontratë, palët kanë deklaruar se janë likuiduar me njëra-tjetrën jashtë zyrës noteriale, pasi është marrë në dorëzim pasuria, pa pretendime për gjendjen e saj.
68. Në analizë të sa më sipër, ndonëse konstaton faktin e mosdeklarimit të të ardhurave të krijuara nga shitja e pasurisë “bodrum me sipërfaqe 194 m<sup>2</sup> në vitin 2008, përkundër detyrimit ligjor të përcaktuar nga dispozitat zbatuese të ligjit nr. 84/2016, në zbërthim të nenit D, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe përcaktimeve në udhëzimin e ILDKPKI-së nr. 4095, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim [...] nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016”, duke e bërë deklarimin e subjektit të rivlerësimit të paplotë në lidhje me këto të ardhura, trupi gjykues, në konsideratë të faktit se ato janë deklaruar rregullisht në deklaratën periodike të vitit 2008, në vitin e krijimit të tyre, vlerëson se konkluzioni i Komisionit për fshehje të këtyre të ardhurave është i pabazuar.

69. Lidhur me pretendimin e subjektit se këto të ardhura kanë shërbyer si burim për shlyerjen e pjesës takuese të kredisë bankare dhe të huasë së marrë prej tij, trupi gjykues, në analizë të fakteve të konstatuara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, se kredia pranë Alpha Bank është shlyer nga subjekti i rivlerësimit në datën 23.05.2008, ndërsa kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme “bodrum” me sipërfaqe 194 m<sup>2</sup> është lidhur në datën 27.05.2008, ku çmimi i shitblerjes rezulton të jetë *likuiduar paraprakisht, totalisht dhe në mënyrë të menjëhershme jashtë zyrës noteriale*, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në fakte konkluzionin e Komisionit se shumica e përdorur për shlyerjen e kredisë nuk ka burim të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurisë “bodrum”.
70. Trupi gjykues vëren se, në mungesë të paraqitjes nga ana e subjektit të rivlerësimit të provave lidhur me kryerjen nga blerësja të pagesës së pjesëshme prej 30.800 eurosh të çmimit të shitblerjes përpara datës së lidhjes së kontratës, pretendimi i subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim, mbeti i në nivel deklarativ. Për rrjedhojë, trupi gjykues gjeti të drejtë dhe të bazuar konkluzionin e Komisionit për konsiderimin në analizën financiare vetëm të burimeve financiare të provuara dhe të dokumentuara deri në datën e shlyerjes së kredisë.
71. Nga kontrolli i kësaj analize financiare të Komisionit nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar shpenzimin prej 15.400 eurosh në vitin 2008, për likuidimin e pjesës së tij takuese të kredisë.
72. *Lidhur me konfliktin e interesit me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, Komisioni ka arritur në përfundimin se: Subjekti i rivlerësimit kishte pasur marrëdhënie me interesa preferencialë ekonomike, konfirmuar në hetimin administrativ, si dhe marrëdhënie miqësie/mirëbesimi, deklaruar nga subjekti si pasojë e lidhjes familjare me z. P. K.. Në kuptim të nenit 5, pika 1, shkronjat “dh”/“v” të ligjit nr. 9367/2005 , i ndryshuar, dhe nenit 72, pika 2 e K.Pr.Civile, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga vendimmarrja në çështjen me palë z. P. K., për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit. Në vlerësim të situatës faktike, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, në këtë vendimmarrje. Lloji i vendimmarrjes nuk përjashton subjektin e rivlerësimit nga detyrimi ligjor që ka pasur për heqjen dorë prej shqyrtimit të kësaj çështjeje.*
73. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar përfundimin e arritur nga Komisioni, me pretendimin se ai është i pambështetur në prova dhe rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit, pasi bazuar në nenet 72 dhe 73 të K.Pr.Civile, legjislatori e ka lënë në vlerësim të gjyqtarit ekzistencën e shkaqeve të arsyeshme për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes dhe jo heqjen dorë detyrimisht – dhe, në rastin objekt shqyrtimi, vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit ka qenë në kah të kundërt me atë që mund të konsiderohej interesi i tij. Subjekti ka parashtruar se në hierarkinë e normave të së drejtës, K.Pr.Civile, i cili ka përparësi ndaj parashikimeve të ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka rregulluar në mënyrë shteruese rastet në të cilat një gjyqtar duhet të japë kryesisht dorëheqjen nga gjykimi i një çështjeje. Norma e përgjithshme që mund të aplikohet në rastin e konfliktit të mundshëm të interesave, është pika 6 e nenit 72 të K.Pr.Civile, e cila përcakton se: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga

gjykimi i një çështjeje konkrete kur: [...] 6. Në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”.

74. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstaton se dy pasuritë e paluajtshme të analizuara më sipër në këtë vendim, janë ndërtuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me ortak të vetëm dhe administrator z. P. K. (bashkëshorti i vajzës së dajës së subjektit) në periudhën 2002-2005. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, subjekti ka deklaruar<sup>17</sup> se ka pasur në gjykim çështjen me objekt “Lëshim urdhër ekzekutimi”, me datë 15.7.2021, me kërkues “{\*\*\*}” ShA, me palë debitore z. K., çka është konfirmuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan<sup>18</sup>.
75. Në shqyrtimin e këtij shkaku ankimi, nga verifikimi i legjislacionit të zbatueshëm në fuqi, konkretisht referuar parashikimeve të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, të cilat përcaktojnë se objekti i kontrollit të kriterit të pasurisë janë pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, trupi gjykues çmoi që gjendja e konfliktit të interesit, në kontekstin e procesit të rivlerësimit, vlerësuar si pjesë e vlerësimit të kriterit të pasurisë, duhet vlerësuar në raport me lidhjen e saj me pasuritë e subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur, ku pasojat juridike të mosjustifikimit të ligjshmërisë së burimeve të pasurive, do të krijohen në ato raste kur këto pasuri janë krijuar si pasojë e gjendjes së konfliktit.
76. Në kontekst të sa më sipër, në kushtet kur nga hetimi administrativ, nuk rezultoi që: (i) subjekti i rivlerësimit të ketë krijuar të ardhura apo pasuri, si pasojë e ndonjë situatë konflikti interesi të pretenduar me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, apo me ortakun e vetëm/administratorin e saj, z. P. K.; si dhe se (ii) gjendja e konfliktit të konstatuar nga Komisioni në vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit të vitit 2021, në procesin gjyqësor me palë ndërgjyqëse z. K., bazuar mbi premisën e njohjes/miqësisë së deklaruar prej tyre, apo marrëdhënies së interesave pasurorë të krijuar rreth 20 vite më parë nga vendimmarrja objekt kontrolli<sup>19</sup>, është vlerësuar në drejtim të detyrimeve të subjektit në raport me veprimtarinë e tij profesionale, kjo situatë faktike nuk mund të përfshihet në objektin e veprimtarisë së nenit 33, pika 5, paragrafi “d” i ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar shkaku e ngritur në ankim lidhur me kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit për ekzistencën e konfliktit të interesit lidhur me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK.

**76.1.** Megjithatë, ndonëse në rastin konkret trupi gjykues vlerëson se nuk gjejnë zbatim kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, në

---

<sup>17</sup> Subjekti ka sqaruar se bëhet fjalë për një gjykim që zhvillohet në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, të iniciuar nga pala kreditore, e cila në këtë rast është {\*\*\*} Elbasan, bazuar në verifikimin formal ‘prima facia’ të faturave të konsumit të ujit nga abonenti, e më pas është lëshuar urdhri i ekzekutimit në favor të kësaj pale, pa analizuar dhe pa verifikuar nëse e drejta e kësaj pale ekziston apo jo. Po ashtu, subjekti ka sqaruar se fakti që ka disponuar kundër interesave të shtetasit P. K., shmang dyshimin për favorizim të tij nga ana e tij.

<sup>18</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.06.2022, ka konfirmuar se subjekti ka gjykuar çështjen në analizë.

<sup>19</sup> Si pasojë e marrëdhënies së sipërmarrjes në ndërtimin e shtëpisë së banimit të subjektit të rivlerësimit.

gjykimin e çështjes me palë z. P. K., kjo çështje mund të ishte trajtuar nga Komisioni në kuadër të vlerësimit të etikës dhe integritetit të magistratit, si pjesë e vlerësimit të aftësive profesionale.

77. *Lidhur me pasurinë automjetit i tipit “Audi A4”, viti i prodhimit 2002, në vlerën 1000 euro, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë mundësinë financiare për blerjen e automjetit tip “Audi”, krijimin e depozitës në Raiffeisen Bank, në emër të bashkëshortes, në datën 20.2.2012 dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara dhe llogaritura, duke rezultuar me bilanc negativ prej (-)421.186 lekësh, për harkun kohor 1.1.2012 – 10.5.2012. Gjithashtu, Komisioni ka konkluduar se veprimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me hyrje-daljet e këtij automjeti nga territori i Republikës së Shqipërisë, përbëjnë zgjedhje, të cilat nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia, në kuptim të parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
78. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke prapësuar se konkluzioni i Komisionit për pamundësinë financiare të subjektit për blerjen e automjetit, është i gabuar dhe rrjedhojë e moskonsiderimit në analizën financiare të gjendjes financiare të subjektit para datës së blerjes së tij, më 01.01.2012, dhe mospërfshirjes së të ardhurave nga shitja e pasurisë “bodrum”. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se fakti që nuk ka deklaruar ndryshime në gjendjen *cash* për periudhën 2003-2011, nuk është i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se ai nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e tij.
79. Subjekti ka kundërshtuar si të pabazuar përfundimin e Komisionit se veprimet e tij me këtë automjet, përbëjnë zgjedhje të cilat nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia. Ai ka pretenduar gjithashtu se mosregjistrimi nga ana e Policisë së Shtetit i daljes së mjetit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk është përgjegjësi e tij, për sa kohë ai nuk u është shmangur kontroleve apo detyrimeve doganore, por ka kryer pagesën sipas çmimit të referencës, bazuar në faturën e lëshuar nga shitësi në vendin e origjinës së mjetit.
80. Trupi gjykues, në analizë të këtij shkaku ankimi, çmoi të theksojë fillimisht se konkluzioni i arritur nga Komisioni lidhur me këtë automjet, është i paqartë, kjo pasi pavarësisht se nga analiza e kryer, subjekti, sipas Komisionit, ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Audi A4”, krijimin e depozitës në Raiffeisen Bank në emër të bashkëshortes, si dhe për mbulimin e shpenzimeve për periudhën 01.01.2012 - 10.05.2012, ai nuk rezulton të ketë arritur në një konkluzion konkret për vlerësimin e kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Ndërsa, sa u përket problematikave në lidhje me hyrje-daljet e mjetit nga territori i Republikës së Shqipërisë, Komisioni duket të ketë konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, por nuk rezulton të ketë identifikuar se cilat veprime konkrete të subjektit duhet të klasifikoheshin, në vlerësimin e tij sipas nenit 61 pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren gjithashtu se as subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse mbi rrethanat e qëndrimit të mjetit në Shqipëri, duke mos shlyer në kohë detyrimet doganore, si dhe mbi mënyrën e daljes së automjetit nga Shqipëria, pa u regjistruar dalja (dhe as nëse ka hyrë e dalë më parë).

81. Nga verifikimi i akteve të fashikullit të çështjes në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si më poshtë.
82. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Automjeti, blerë sipas kontratës së shitblerjes, datë 10.5.2012, përkundrejt shumës 1.000 euro. Burimi i krijimit: kursimet nga të ardhura familjare [...].* Ndërsa, në deklaratën periodike të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Autoveturë e markës “Audi”, tip A4, vit prodhimi 2002, në shumën 1.000 euro, si dhe ka deklaruar kontratën e shitblerjes së datës 10.5.2012 dhe zhdoganimin dhe regjistrimin në shtator të vitit 2013.*
83. Lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën periodike të vitit të krijimit të saj, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, të dërguar nga Komisioni, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *[...] kontrata e shitblerjes së mjetit “Audi” me targë {\*\*\*}, është bërë në datën 10.05.2012. Për këtë arsye, deklarimi i kësaj pasurie është bërë në DIPV-në e vitit 2013, për shkak se kontrata e shitblerjes është bërë pas datës 31 mars 2012. Po në këtë pyetësor, i pyetur në lidhje me faktin që zhdoganimi dhe regjistrimi i këtij automjeti është bërë gati 1 vit e 3 muaj nga data e blerjes dhe, pas përdorimit të tij, për periudhën maj 2012 – shtator 2013, ka deklaruar se: Për shkak të kohës së gjatë, nuk mund të kujtoj me saktësi periudhën e saktë të përdorimit të këtij mjeti dhe veprimet e kryera me të, por, me sa kujtoj, deri në momentin e zhdoganimit të mjetit dhe regjistrimit të tij pranë DRSHTRR-së, nuk e kam përdorur këtë mjet, pasi rezultoi me probleme që lidheshin me gjendjen teknike të mjetit.*
84. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes së mjetit në pronësi të subjektit, të përcjellë nga DPSHTRR-ja, ndër të tjera, evidentohet edhe një deklaratë e datës 10.05.2012, në të cilën shtetasi E. T. ka deklaruar shitjen e automjetit “Audi A4”, z. Taulant Tafa, në vlerën 1.000 euro; një deklaratë doganore me nr. {\*\*\*}, datë 13.09.2013, për zhdoganimin e automjetit, një mandatpagesë e datës 13.09.2013 nga Raiffeisen Bank për: “Derdhje në favor të zyrove doganore” të shumës prej 54.313 lekësh nga z. Taulant Tafa; si dhe certifikatë regjistrimi për mjetin, në datën 16.09.2013.
85. Trupi gjykues vëren se Komisioni, analizën financiare për verifikimin e mundësisë financiare të subjektit për krijimin e kësaj pasurie, rezulton ta ketë kryer bazuar në datën e blerjes së kësaj pasurie, për periudhën 01.01.2012 – 10.05.2012, duke përfshirë në këtë analizë edhe pasurinë “depozitë” të bashkëshortes së subjektit në Raiffeisen Bank, të krijuar në datën 20.02.2012, si dhe shpenzimet e kryera për këtë periudhë. Nga kjo analizë, subjekti ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme në shumën prej (-) 421.186 lekësh, për blerjen e automjetit në shumën 1.000 euro, krijimin e depozitës në Raiffeisen Bank dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë periudhë, rezultat ky i cili, pas kontrollit të ushtruar në Kolegj nga Njësia e Shërbimit Ligjor, u gjet i drejtë dhe i bazuar.
86. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me konsiderimin e gjendjes financiare të subjektit para datës së blerjes së tij këtij automjeti dhe përfshirjes në analizë të të ardhurave nga shitja e pasurisë “bodrum” në vitin 2008, të cilat u gjetën të pabazuara në fakte. Ky konkluzion vjen si rrjedhojë e konstatimit se, pavarësisht se përdorimi i kursimeve nuk rezultoi të ishte deklaruar si burim për krijimin e kësaj

pasurie, nga shqyrtimi i deklarimeve të interesave periodikë/privatë vjetorë të depozituar nga subjekti pranë ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të kishte kursime *cash* të akumuluar deri në fund të vitit 2011, për të mundur t'i përdorte në vitin 2012, pasi nuk rezultoi të kishte deklaruar shtesa dhe pakësime, kursime gjendje *cash* në banesë për periudhën 2003 – 2011.

87. Sa u takon problematikave të konstatuara nga Komisioni në lidhje me veprimet e subjektit të rivlerësimit me automjetin objekt kontrolli, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstaton se, gjatë hetimit administrativ, Dega e Doganës Elbasan<sup>20</sup>, ka bërë me dije se automjeti “Audi A4”, me targë {\*\*\*}, ka hyrë në pikën kufitare Qafë Thanë në datën 12.09.2013, nga shtetasi R. J.. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit<sup>21</sup> ka bërë me dije se për mjetin me targë {\*\*\*}, për sa u përket të dhënave nga sistemi TIMS, rezultojnë vetëm dy hyrje në territorin shqiptar, konkretisht në datën 06.07.2011 në Durrës nga shtetasi E. T. dhe në datën 12.09.2013 nga shtetasi R. J.. Ndërkohë që, referuar deklaratës doganore {\*\*\*}, zhdoganimi i automjetit është bërë në datën 13.09.2013.
88. I pyetur nga Komisioni në lidhje me këtë konstatim, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka sqaruar se, për shkak të problemeve që lidheshin me gjendjen teknike të automjetit, ai nuk është përdorur deri në momentin e zhdoganimit të tij. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka sqaruar se: *Pasi mjetit të tipit “Audi”, prodhim i vitit 2002, i bëra disa shërbime në mënyrë që të ishte në gjendje të rregullt teknike, u interesova për t'i bërë procedurat e zhdoganimit. Nga ana e agjencisë doganore, m'u bë me dije se ka kaluar një periudhë e gjatë kohore qëkur mjeti ka hyrë në territorin shqiptar dhe nuk dihet se çfarë është bërë me këtë mjet në shtetin italian, nëse janë kryer procedurat e çregjistrimit në shtetin italian dhe nëse makina ka apo jo probleme në lidhje me dokumentacionin në shtet të huaj. Për këtë arsye, mënyra më e mirë për t'u siguruar që mjeti nuk kishte probleme, më duhej ta kaloja në një pikë doganore. Duke qenë se pika më e afërt doganore ishte pika e kalimit kufitar Qafë Thanë, vendosa të shkoj atje për t'u siguruar. U paraqita në një nga agjencitë në doganën e Qafë Thanës dhe, me sa më kujtohet, spedinsioneri i asaj agjencie bëri kalimin e mjetit dhe verifikimet për të cilat unë isha i interesuar, nëse mjeti kishte problem apo ndonjë denoncim të mundshëm në shtetin italian. Këtë veprim e kam ndërmarrë pasi në atë periudhë mjaft automjete që hynin në territorin e Shqipërisë, më pas rezultoi me probleme dokumentacioni apo edhe të vjedhura, duke u bërë fenomen shqetësues për kohën [...].*
89. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerëson se rrethanat e konstatuara si më sipër, lidhur me: (i) mosdeklarimin e blerjes së mjetit në deklaratën periodike të vitit 2012; (ii) zhdoganimin dhe regjistrimin e këtij mjeti rreth 1 vit e tre muaj më vonë nga data e blerjes së tij; si dhe (iii) mosparaqitjen e ndonjë dokumenti justifikues në mbështetje të deklaratimit të subjektit mbi shërbimet e kryera për mjetin – pavarësisht se demonstronjë problematika në drejtim të ndjekjes së procedurave ligjore lidhur me këtë automjet, nuk u vlerësuan të një rëndësie të atillë, që mund të cenonjë figurën e gjyqtarit e të passjellin një konkluzion për cenim të besimit të

<sup>20</sup> Me shkresën kthim përgjigjeje nr. {\*\*\*} prot., datë 13.06.2022.

<sup>21</sup> Me shkresën kthim përgjigjeje nr. {\*\*\*} prot., datë 25.07.2022.

publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht sa më sipër, problematikat e konstatuara u çmuan në kuadër të vlerësimit të besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e pasurisë.

90. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues arriti në konkluzionin se, për pasurinë e llojit automjet, të markës “Audi”, tip A4, me targë {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
91. Lidhur me shkakun e ankimit mbi rezultatin e analizës financiare për periudhën 2003 – 2006, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka arritur në përfundimin se: *Subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të provojnë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të Komisionit me barrën e provës në rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me balancat negative, përkatësisht për vitin 2005 në vlerën (-) 7.665.454 lekë, për vitin 2006 në vlerën (-) 1.173.231 lekë, për vitin 2007 në vlerën (-) 1.173.297 lekë, për vitin 2008 në vlerën (-) 622.993 lekë, për vitin 2012 në vlerën (-) 263.588 lekë dhe për vitin 2016 në vlerën (-) 182.892 lekë, duke rezultuar me një balancë negative për vitet e deklarimit, në vlerën e përgjithshme prej (-) 11.081.455 lekësh. Mungesa e burimeve të ligjshme financiare në vlerën e përgjithshme prej (-) 11.081.455 lekësh, në krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën e deklarimit, e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në përputhje me parashikimet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 61 dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.*
92. Subjekti, në kundërshtimin e këtij konkluzioni, ka pretenduar t’i përlloragriten në analizën financiare edhe të ardhurat e përfituara nga qiraja, në shumën prej 100.000 lekësh në muaj, për arsye se qiramarrësi ka qenë një subjekt tregtar dhe jo një individ dhe, sipas legjislacionit tatimor për këto raste, përgjegjësia për pagesën e detyrimeve të qirasë e ka qiramarrësi. Referuar legjislacionit tatimor, sipas subjektit, lejohet pagesa në *cash* për vlera më të vogla se 130.000 lekë, për rrjedhojë nuk ka qenë e detyrueshme pagesa e kësaj qiraje nëpërmjet llogarisë bankare. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se, duke marrë për bazë deklaratat e pasurisë ndër vite, të cilat, referuar ligjit nr. 84/2016, kanë vlerën e provës, deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe duke përfshirë në analizën financiare shumat e pretenduara në ankim, rezulton se subjekti i rivlerësimit është në kufijtë e aplikimit të parimit të proporcionalitetit, çka nuk e vendos subjektin në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
93. Trupi gjykues, në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi dhe kontrollit të vendimit të Komisionit lidhur me pretendimet e subjektit, pasi mori në analizë aktet e fashikullit të çështjes, konstaton se në deklaratën periodike të vitit 2007, subjekti rezulton të ketë deklaruar të ardhura nga kontrata e dhënies me qira të pasurisë nr. {\*\*\*}, z. k. {\*\*\*}, shtetasit D. D., të një sipërfaqeje bodrumi në shumën 100.000 lekë në muaj, në total 1.200.000 lekë. Fakti i dhënies me qira të pjesës takuese të bodrumit, rezulton edhe në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 7.1.2015, ku subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, ndër të tjera, se: *[...] Kam paguar 1.000.000 lekë nga kredia e marrë, pjesën tjetër e ka shfrytëzuar z. D. për rregullimin e bodrumit të cilin e ktheu në lokal. Pjesën time të bodrumit ia dhashë me qira z. D.[...].*

94. Trupi gjykues konstaton se, nga të dhënat e hetimit administrativ, nuk rezultoi që lidhur me këto të ardhura të deklaruara si të realizuara nga një marrëdhënie qiraje me z. D. D., të ishte depozituar nga subjekti i rivlerësimit ndonjë kontratë, sipas së cilës të provohej materializimi i kësaj marrëdhënieje juridiko-civile të pretenduar. Gjatë hetimit administrativ, nuk rezultoi asnjë e dhënë tjetër lidhur me këtë marrëdhënie qiraje, shumat e pretenduara (mënyrën e përfitimit të tyre) apo shlyerjen e detyrimeve tatimore në kuadër të parashikimeve të ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale, qoftë nga qiradhënësi apo edhe nga qiramarrësi.
95. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se mospërfshirja nga Komisioni e të ardhurave nga qiraja, të cilat për më tepër rezultuan të mos ishin deklaruar as në deklaratën e pasurisë *vetting*, ishte bazuar në fakte dhe në ligj, sa kohë përfitimi i këtyre të ardhurave nuk u arrit të provohet nga subjekti i rivlerësimit as gjatë gjykimit në Kolegj.
96. Në përfundim, trupi gjykues, pasi kontrollloi analizën financiare të Komisionit për periudhën 2004-2016 nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, mbi bazën e pretendimeve të subjektit, bazuar në konkluzionet e arritura nga shqyrtimi i tyre, konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultuan me mungesë të burimeve të ligjshme financiare, sipas të njëjtave balanca negative, përkatësisht: për vitin 2005 në vlerën (-) 7.665.454 lekë; për vitin 2006 në vlerën (-) 1.173.231 lekë, për vitin 2007 në vlerën (-) 1.173.297 lekë, për vitin 2008 në vlerën (-) 622.993 lekë, për vitin 2012 në vlerën (-) 263.588 lekë dhe për vitin 2016 në vlerën (-) 182.892 lekë, në total për të gjithë periudhën (-) 11.081.455 lekë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5 ,shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- **Gjetje të tjera nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**
97. Lidhur me përdorimin e automjetit të markës “Audi”, me targë {\*\*\*}, në pronësi të shtetasit R. B., Komisioni ka arritur në konkluzionin se: [...] pasi analizoi rrethanat rezultuara nga hetimi, të tilla si: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si në deklaratën *vetting*, dhe as në pyetësorin standard përdorimin nga ana e tij të automjetit të markës “Audi”; (ii) shkëmbimi i përdorimeve të automjeteve me shtetasin R. B. dhe shpjegimet e subjektit në përgjigje të barrës së provës – ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pasuri, ndodhet në kushtet e parashikimeve të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “c”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
98. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit lidhur me mosdeklarimin në deklaratën *vetting*, dhe as në pyetësorin standard, të automjetit të markës “Audi”, me pretendimin se këtë mjet nuk e ka përdorur në vijimësi, por e ka përdorur vetëm 4 herë gjatë periudhës 13.11.2016 – 01.09.2019, çka në kuptim të përcaktimeve të Kodit Civil, nuk konsiderohet përdorim.
99. Po ashtu, subjekti ka pretenduar se, për sa kohë ai nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit me pronarin e këtij mjeti, shtetasin R. B., “gabimi njerëzor” i mosdeklarimit nuk duhet të sjellë pamjaftueshmëri/pasaktësi në deklaram.

100. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, si dhe shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij në përgjigje të barrës së provës, vëren se ky automjet, përkundër detyrimit kushtetues dhe ligjor të subjektit të rivlerësimit për deklarinimin me saktësi të çdo pasurie në përdorim/posedim, nuk rezulton të jetë deklaruar prej këtij të fundit as në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as në pyetësin standard të dërguar nga Komisioni, në të cilin, ndër të tjera, është pyetur shprehimisht në lidhje me pasuri në përdorim të tij.
101. Në lidhje me mosdeklarimin në pyetësin standard të përdorimit të këtij automjeti, në përgjigje të pyetësit nr. 3, të dërguar nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se: *Në këtë pyetësor, kam deklaruar faktin që kam përdorur automjete të personave të tjerë në periudha të ndryshme kohore, por nuk kam specifikuar detajet, pasi nuk kam menduar që duheshin përcaktuar në atë fazë. Po ashtu, subjekti ka dhënë sqarime lidhur me situatën e përdorimit të tij në 4 raste, të shtrira në periudhën kohore 2016 – 2019<sup>22</sup>, duke potencuar se me pronarin e automjetit ka marrëdhënie shumë të ngushta (duke përfshirë marrëdhënie interesi apo të tjera, të ndryshme nga ato shoqërore).*
102. Në bazë të informacionit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, rezulton se ky automjet, në periudhën 2016 – 2019, ka qenë në pronësi të shtetasit R. B. dhe, gjatë kësaj periudhe, janë regjistruar 4 hyrje - dalje në sistemin TIMS nga subjekti i rivlerësimit<sup>23</sup>, përkatësisht në datat 13.11.2016, 15.09.2018, 27.12.2018 dhe 01.09.2019. Ndërkohë që sipas policës së sigurimit të datës 14.09.2016, z. R. B. ka rezultuar përdorues i automjetit të markës “Audi” me targë {\*\*\*}, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.
103. Trupi gjykues, në analizë të këtij shkakut ankimi, çmoi fillimisht të evidentojë se konkluzioni i arritur nga Komisioni lidhur me këtë automjet, është i paqartë, pasi nuk ka përcaktuar në mënyrë të qartë e të shprehur për çfarë situatë faktike ka vlerësuar zbatimin e parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, fshehjen e përdorimit apo fshehjen e pasurisë automjet. Trupi gjykues vëren se, ndonëse evidentohet një udhëtim i kryer nga subjekti jashtë vendit me këtë automjet në datën 13.11.2016, përpara se subjekti të dorëzonte deklaratën *vetting*, nga rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nuk rezulton të jetë provuar pasja në përdorim apo posedim e këtij mjeti në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*. Në këtë kuptim, trupi gjykues, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, vlerëson se të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ nuk janë të mjaftueshme për kualifikimin e kësaj situatë faktike sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.
104. *Lidhur me përdorimin e automjetit me targë {\*\*\*}, në pronësi të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka arritur në përfundimin se: Veprimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me përdorimin e automjetit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, pasi ka gjykuar çështjen me palë*

<sup>22</sup> Në datat 13.11.2016, 24.12.2018 dhe 27.08.2019, nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Murriqan, ndërsa në datën 14.09.2018, nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Tushemisht.

<sup>23</sup> Ky automjet është blerë në vijim nga subjekti i rivlerësimit sipas kontratës së shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.10.2020, për çmimin 420.000 lekë.

*ndërgjyqëse shoqërinë dhe palë të paditur Bashkinë Elbasan, me objekt “Përmbushja e detyrimit kontraktor”, ka cenuar besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

105. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar se vendimmarrja e tij në një proces gjyqësor në vitin 2011, në të cilin shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka qenë palë paditëse, në mungesë të të dhënave për kontakte apo marrëdhënie me përfaqësues të kësaj shoqërie, përjashton mundësinë e ekzistencës së konfliktit të interesit në këtë gjykim apo në një moment të mëvonshëm menjëherë pas këtij gjykimi. Ndërsa, në lidhje me gjykimin e një tjetër çështjeje me objekt “Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit”, në vitin 2021, në të cilën shoqëria “{\*\*\*}” ShPK kishte qenë palë, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim se ky është një gjykim formal që zhvillohet në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, dhe bazohet në kontrollin formal të akteve provuese të depozituara në gjykim. Për rrjedhojë, sipas subjektit, referuar përcaktimit në pikën 6 të nenit 72 të K.Pr.Civile, e cila përcakton se: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: [...] 6. Në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”, i interpretuar në harmoni me përcaktimet në nenet 72 dhe 73 të këtij Kodi, legjislatori e ka lënë në vlerësim të gjyqtarit, bazuar në bindjen e tij të brendshme, ekzistencën e shkaqeve të arsyeshme për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes dhe jo heqjen dorë detyrimisht. Subjekti ka referuar se, që prej vitit 2015, ka krijuar marrëdhënie shoqërore me shtetasin F. K., administratorin e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, e cila rezultoi se kishte në pronësi automjetin me të cilin ai ka udhëtuar. Sipas subjektit, përpos natyrës së çështjes (me objekt lëshim i urdhrit të ekzekutimit) të gjykuar në vitin 2011 me palë këtë shtetas, fakti që është kryer vetëm 1 udhëtim në vitin 2016 (për të shkuar në Maqedoni për një gëzim familjar, për arsye se automjeti i tij ishte me defekt) nuk mund të prodhojë situatën e konfliktit të interesit.
106. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstaton se, sipas të dhënave të sistemit TIMS, subjekti, në datën 17.04.2016, ka udhëtuar me automjetin me targë {\*\*\*}, në pronësi të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Po ashtu, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan<sup>24</sup> pranë Komisionit, rezultoi se subjekti ka gjykuar në dy çështje me palë shoqërinë në fjalë, konkretisht: (i) në çështjen e finalizuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.04.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me paditës shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK dhe palë të paditur Bashkinë Elbasan, me objekt “Përmbushjen e detyrimit kontraktor”, ku në përfundim të gjykimit, ka vendosur në favor të palës paditëse, shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, duke pranuar pjesërisht padinë dhe detyruar palën e paditur, Bashkinë Elbasan, të shpërblejë palën paditëse në vlerën 80.030.574 lekë; dhe (ii) çështjen e finalizuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 17.12.2021, me objekt “Lëshim urdhër ekzekutimi”, në të cilën subjekti ka disponuar kundër kësaj shoqërie.
107. Nga verifikimi i legjisllacionit të zbatueshëm në fuqi, konkretisht referuar parashikimeve të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, të cilat përcaktojnë se objekti i kontrollit të kriterit të pasurisë janë pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, trupi gjykues çmoi që gjendja e konfliktit të interesit, në kontekstin e procesit të rivlerësimit,

<sup>24</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 20.6.2022.

vlerësuar si pjesë e vlerësimit të kriterit të pasurisë, duhet vlerësuar në raport me lidhjen e saj me pasuritë e subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur, ku pasojat juridike të mosjustifikimit të ligjshmërisë së burimeve të pasurive, do të krijohen në ato raste kur këto pasuri janë krijuar si pasojë e gjendjes së konfliktit.

108. Në kontekst të sa më sipër, në kushtet kur nga hetimi administrativ nuk rezultoi që përdorimi i automjetit në vitin 2016 të kishte një lidhje direkte me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit në favor të shoqërisë pronare të automjetit në vitin 2011, trupi gjykues vlerëson se, në rastin konkret, nuk gjejnë zbatim kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, në gjykimin e çështjes me palë shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK.
109. Pavarësisht sa më sipër, përdorimi i automjeteve të personave me të cilët subjekti ka gjykuar procese gjyqësore, ku këta shtetas kanë pasur pozitën procedurale të palës ndërgjyqëse, çmuar kjo në kuadër të qëllimit për të garantuar besimin e publikut në paanësinë e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, u mbajt në konsideratë nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor të tri kriterëve, në kuptim të parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
110. *Lidhur me përdorimin në datën 14.09.2019, nga subjekti, të automjetit me targë {\*\*\*} në pronësi të shtetasve K. B. dhe V. B., trupi gjykues konstaton se Komisioni ka arritur në përfundimin se: Përdorimi i automjetit të shtetasit V. B., nga subjekti i rivlerësimit, pasi ky i fundit kishte shqyrtuar çështjen penale nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2012, me këtë shtetas, akuzuar për veprat penale “Plagosje e rëndë në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, parashikuar nga neni 88/b i Kodit Penal, “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe “Kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, përbën zgjedhje, e cila jo vetëm nuk shërben në krijimin e besimit të publikut te drejtësia, por ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, në kuptim të parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
111. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar se përfundimet e arritura prej tij, bazohen në prezumimin e paprovuar për ekzistencën e një marrëdhënieje mes subjektit dhe shtetasit V. B., prezumim i cili nuk gjen mbështetje në aktet provuese dhe se Komisioni nuk e ka adresuar këtë çështje për të marrë përgjigje nga subjekti i rivlerësimit. Në mungesë të një situatë të qartësuar në lidhje me pronësinë e mjetit, përdorimin e vazhdueshëm të tij nga shtetasi V. B. dhe marrëdhënien e subjektit me pronarët e mjetit, sipas subjektit, e bën të pabazuar konkluzionin e arritur nga Komisioni.
112. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstaton se: (i) sipas të dhënave të sistemit TIMS, në datën 14.09.2019, subjekti ka kryer një udhëtim me një automjet në pronësi të shtetasve K. B. dhe V. B.; (ii) subjekti ka gjykuar çështjen penale me nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2012, me të pandehur shtetasin V. B., i akuzuar për veprat penale “Plagosje e rëndë në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, parashikuar nga neni 88/b i Kodit Penal, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe “Kanosja” parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal; (iii) nga denoncimet e depozituara pranë Komisionit, referohen indicie për favorizim të të pandehurit nga ana e subjektit të rivlerësimit, në çështjen penale me nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2012, caktimi i subjektit si gjyqtar i çështjes pa short elektronik

të rregullt, zvarritje e gjykimit, zbutje e masës së dënimit ndaj të pandehurit, mungesë analize dhe cilësimi ligjor të veprës penale, si dhe çmuarja e provave në kundërshtim me përcaktimet e nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale.

113. Trupi gjykues, pasi analizoi dosjen gjyqësore<sup>25</sup> që i përket çështjes penale nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2012, konstatoi se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit V. B., për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” dhe dënimin e tij me një vit burgim, parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal, “Plagosje e rëndë në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, parashikuar nga neni 88/b i Kodit Penal dhe dënimin me 2 vjet dhe 9 muaj; si dhe “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal dhe dënimin me tre muaj.
114. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2012, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, ka vendosur: *Deklarimin fajtor të shtetasit V. B., për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, “Plagosje e rëndë në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, neni 88/b i Kodit Penal dhe “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal dhe bashkimin e dënimeve dhe dënimin përfundimisht me 1 vit dhe 9 muaj burg dhe, në zbatim të nenit 406/1, dënimin e tij përfundimisht me 1 vit e dy muaj burgim.*

Trupi gjykues, në analizë të sa më sipër konstatuar, e gjen të drejtë dhe të bazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit, me përdorimin prej tij të automjetit në pronësi të shtetasit V. B., i cili ishte gjykuar më parë nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe dënuar për kryerjen e një vepre penale, pavarësisht kohës kur kishte disponuar me vendim, çmohet si sjellje e një rëndësie të tillë që cenon besueshmërinë e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

### ***Ç. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës***

115. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar se përfundimet e arritura prej tij, bazohen në prezumimin e paprovuar për ekzistencën e një marrëdhënieje mes subjektit dhe shtetasit V. B., prezumim i cili nuk gjen mbështetje në aktet provuese dhe se Komisioni nuk e ka adresuar këtë çështje për të marrë përgjigje nga subjekti i rivlerësimit. Mungesa e një situatë të qartësuar në lidhje me pronësinë e mjetit, përdorimin e vazhdueshëm të tij nga shtetasi V. B. dhe marrëdhënien e subjektit me pronarët e mjetit, sipas subjektit, e bën të pabazuar konkluzionin e arritur nga Komisioni.
116. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi trupi gjykues, konstaton se: (i) sipas të dhënave të sistemit TIMS, në datën 14.09.2019, subjekti ka kryer një udhëtim me një automjet në pronësi të shtetasve K. B. dhe V. B.; (ii) subjekti ka gjykuar çështjen penale me nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2012, me të pandehur shtetasin V. B., i akuzuar për veprat penale “Plagosje e rëndë në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, parashikuar nga neni 88/b i Kodit Penal, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe “Kanosja”,

<sup>25</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal; (iii) nga denoncimet e depozituara pranë Komisionit, referohen indicie për favorizim të pandehurit nga ana e subjektit të rivlerësimit, në çështjen penale me nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2012, caktimi i subjektit si gjyqtar i çështjes pa short elektronik të rregullt, zvarritje e gjykimit, zbutje e masës së dënimit ndaj të pandehurit, mungesë analize dhe cilësimi ligjor të veprës penale, si dhe çmuarja e provave në kundërshtim me përcaktimet e nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale.

117. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstaton se, në kuadër të hetimit të zhvilluar lidhur me kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, Komisioni, në përfundim të këtij hetimi, lidhur me *procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2020, në ngarkim të të pandehurit A. Ç.*, ka arritur në konkluzionin se, pas hetimit të kryer bazuar në nenin Dh të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të DSIK-së, rezultateve të hetimit lidhur me çështjen e referuar më lart dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë subjekti, krijoi bindjen se informacioni që disponohej në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, sipas kërkesave të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë vendimmarrje, ishte i bazuar në fakte dhe rrethana konkrete. Këtë konkluzion e ka mbështetur në arsyetimin se: *[...] nga subjekti, pavarësisht provave të administruara dhe fakteve të provuara, në procesin gjyqësor, nuk është mbajtur në konsideratë në caktimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim, neni 48 i Kodit Penal, sipas të cilit rrethanat lehtësuese të parashikuara në shkronjën “e” të këtij neni, nuk lehtësojnë dënimin e një personi që ka kryer një veprë penale të dhunës në familje. Komisioni vlerëson se, në këtë vendim, nga subjekti nuk është mbajtur në konsideratë në caktimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim se i pandehuri, referuar certifikatës së gjendjes gjyqësore nr. {\*\*\*} prot., datë 26.5.2020, ka qenë “i dënuar”. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit në këtë vendimmarrje, është gjetur në zbatim të gabuar dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal material dhe procedural.*
118. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të çështjes që i përket procedimit penal me nr. {\*\*\*}/2020., në ngarkim të të pandehurit A. Ç., i dyshuar për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal, në dëm të viktimës E. Ç., subjekti i rivlerësimit, referuar rrethanave të tilla, si: (i) rrezikshmëria e të pandehurit, shkalla e fajit, gjendja sociale, familjare, ekonomike; (ii) fakti që është person i padënuar më parë; (iii) fakti që marrëdhëniet me viktimën momentalisht janë të normalizuara, si dhe rrethana të tjera që do të mbahen parasysh në kuptim të nenit 49 të Kodit Penal, si dhe (iv) mungesa e rrethanave rënduese ka vendosur: *[...] Deklarimin fajtor të të pandehurit A. Ç. dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim sipas nenit 130/a/4 të Kodit Penal dhe në bazë të neneve 48/ç, 49 të Kodit Penal. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale – dënimin e të pandehurit me 8 muaj burgim. Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal – pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim të të pandehurit A. A. Ç. dhe zëvendësimin e tij me detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik.* Ndaj këtij vendimi, nuk është ushtruar ankimi.
119. Trupi gjykues vëren se, në rastin e veprave penale të parashikuara nga neni 130/a i Kodit Penal, ndryshe nga sa ka konstatuar dhe vlerësuar subjekti i rivlerësimit në vendimin penal në ngarkim të të pandehurit A. Ç., i dyshuar për veprën penale “Dhuna në familje”, marrëdhëniet e

normalizuar midis të pandehurit dhe viktimës nuk konsiderohen si rrethana në kuptim të nenit 48 të Kodit Penal. Në vendimin e dhënë prej tij, subjekti ka parashtruar gjithashtu si rrethanë lehtësuese faktin që i pandehuri është person “i padënuar” më parë, ndërkohë që, sipas certifikatës së gjendjes gjyqësore të datës 26.05.2020, me nr. {\*\*\*} prot., administruar në dosje, ka rezultuar se i pandehuri ka qenë “i dënuar”.

120. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerëson se konstatimet e Komisionit të rezultuara nga kontrolli i vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit lidhur me procedimin penal me nr. {\*\*\*}/2020., ndonëse rezultuan të bazuara në ligj, nuk mund të justifikojnë konkluzionin e arritur nga ky i fundit në lidhje me vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit: *informacioni që disponohej në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, sipas kërkesave të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë vendimmarrje, ishte i bazuar në fakte dhe rrethana konkrete*, por ato u mbajtën në konsideratë nga trupi gjykues në vlerësimin në tërësi të çështjes, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të efektit të veprimtarisë profesionale të subjektit në kuadër të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
121. Nga kontrolli i *vendimit penal me nr. {\*\*\*}, datë 24.12.2018, ndaj të pandehurit Sh. H.*, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit në këtë vendimmarrje, është gjetur në zbatim të gabuar dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal material dhe procedural për zbatimin e nenit 64 të Kodit Penal. *Këtë konkluzion, Komisioni e ka bazuar në arsyetimin se: bazuar në nenin Dh të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të DSIK-së, rezultateve të hetimit lidhur me çështjen e referuar më lart dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë subjekti, krijoi bindjen se informacioni që disponohej në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, sipas kërkesave të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë vendimmarrje, ishte i bazuar në fakte dhe rrethana konkrete.*
122. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtimin e këtij konkluzioni të Komisionit, ka pretenduar se për aplikimin e nenit 64 të Kodit Penal, ai është bazuar në vlerësimin pozitiv të sjelljes së të pandehurit nga ana e Institutit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (në vijim “IEVP”), raportit të paraqitur nga ana e Shërbimit të Provës, ku është konkluduar se riintegrimi i të dënuarit në shoqëri është i mundshëm, si dhe kërkesës së palëve në seancë të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës dhe lirin me kusht të të dënuarit. Po ashtu, subjekti ka parashtruar se, në mungesë të pretendimeve në lidhje me përmbajtjen e fakteve që pasqyrohen në raportin mbi dinamikën e vuajtjes së dënimit, i cili është një dokument zyrtar që përpilohet nga IEVP-ja dhe që administrohet si provë gjatë gjykimit – gjykata nuk mund t’ia nënshtrojë atë dokument hetimit gjyqësor. Po ashtu, subjekti ka potencuar se vendimi është i formës së prerë dhe nuk është ankimuar nga palët, çka tregon se palët nuk kanë pasur kundërshti në lidhje me vendimmarrjen e tij. Sipas subjektit, ligjvënësi e ka lënë në vlerësim të gjykatës se cilat do të konsiderohen arsyet e veçanta për lirin me kusht të të dënuarit.

123. Trupi gjykues, në analizë të dosjes së administruar nga Komisioni, lidhur me çështjen objekt kontrolli, konstatoi se, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 13.10.2015, i pandehuri Sh. H. është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/a/2 e 22 i Kodit Penal dhe është dënuar me 13 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, është dënuar përfundimisht me 8 vjet e 8 muaj burgim. Në vijim, me kërkesën nr. {\*\*\*} të datës 09.07.2018, i dënuar Sh. H. i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan me kërkesë për lirimin me kusht, e cila, sipas vendimit të datës 23.07.2018, të marrë nga subjekti i rivlerësimit, ka vendosur kalimin në seancë gjyqësore të çështjes me objekt “Lirimin me kusht” të kërkuarit Sh. H..
124. Nga aktet në dosje, vërehet se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan është administruar, ndër të tjera, edhe dokumenti “Dinamikë e vuajtjes së dënimit për të dënuarin”, ku pasqyrohet se deri në datën 24.09.2018, i dënuari/kërkuesi kishte vuajtur 6 vjet e 1 muaj e 18 ditë, nga të cilat 10 muaj e 22 ditë i ka fituar me paraburgim, 3 muaj janë ulur nga dënimi me vendimin me nr. {\*\*\*}, datë 19.02.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, rezulton që të dënuarit t’i jetë ulur dënimi me 90 ditë, në zbatim të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, si dhe 90 ditë i janë ulur nga dënimi me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.02.2017, të kësaj Gjykate. Sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit, të dënuarit i kanë mbetur për të vuajtur edhe 1 vit e 10 muaj e 12 ditë.
125. Me vendimin me nr. {\*\*\*} të datës 24.12.2018, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, bazuar në nenin 64<sup>26</sup> të Kodit Penal ka vendosur: [...] *Pranimin e kërkesës. Lirimin me kusht të kërkuarit Sh. H., duke ia dhënë kohën e pavuajtur të dënimit prej 1 vit, 7 shtatë muaj dhe 12 ditë, me kusht që gjatë kësaj periudhe të mos kryejë veprë tjetër penale me dashje [...].*
126. Në arsyetimin e vendimit, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur në konsideratë: a) arsyet e veçanta në kuptim të nenit 64, duke konsideruar si të tilla, gjendjen ekonomike dhe shëndetësore të familjes së kërkuarit dhe vetë kërkuarit; b) sjelljen dhe qëndrimin e të dënuarit në vendin e vuajtjes së dënimit; c) faktin që i dënuari ka kryer më shumë se  $\frac{3}{4}$  e masës së dënimit të dhënë ndaj tij; si dhe d) faktin se i dënuari nuk ka qenë i dënuar përsëritës për vepra penale të kryera me dashje.
127. Për sa më sipër, trupi gjykues e gjen të bazuar konstatimin e Komisionit se për përcaktimin e “arsyeve të veçanta”, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar në kundërshtim me përcaktimin e vendimit unifikues nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit: *Në shumë çështje gjyqësore me objekt lirimin me kusht, janë pretenduar si “arsye të veçanta” rrethana të tilla, si për shembull gjendja familjare e rënduar e të dënuarit; sëmundja e rëndë e prindërve apo e të afërmeve të tjerë; apo qenia me fëmijë të mitur dhe me bashkëshortë në ngarkesë të të dënuarit. Në vlerësimin e Kolegjeve të Bashkuara, kjo qasje është e papranueshme dhe e*

<sup>26</sup> “[...] I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur: - jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale; - jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim; jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni. Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfutur me amnisti ose falje [...]”.

*gabuar. Kjo pasi në interpretimin që i kanë bërë shprehjes “arsye të veçanta”, gjykatat më të ulëta efektivisht kanë shtuar me pa të drejtë një kriter të jashtëm të paparashikuar nga ligji si kusht ndalues për efekt të pranimit të kërkesës për lirim me kusht. Megjithatë, [...] Kolegjet vlerësojnë se rrethanat që kanë të bëjnë me familjarët e të dënuarit mund të merren parasysh nga ana e gjykatave jo si kusht thelbësor, por si rrethanë që shkon në favor të kërkesës për lirim me kusht, në drejtim të analizës së gjykatës për riintegrimin e plotë të dënuarit pas lirimit.*

128. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se ky konstatim për zbatimin e nenit 64 të Kodit Penal, në kundërshtim me arsyetimin në vendimin unifikues nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 24.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nuk mund të justifikojë konkluzionin e arritur nga Komisioni në lidhje me vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit: *informacioni që disponohej në ngarkim të subjektit të rivlerësimit sipas kërkesave të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë vendimmarrje, ishte i bazuar në fakte dhe rrethana konkrete, por ato u mbajtën në konsideratë nga trupi gjykues në vlerësimin në tërësi të çështjes sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të efektit të veprimtarisë profesionale të subjektit në drejtim të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.*
129. Trupi gjykues vëren se, lidhur me *procedimin penal me nr. {\*\*\*}/2004*, me të pandehur shtetasit M. H., E. I., S. M., të akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve në bashkëpunim”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal”, dhe shtetasin E. L., i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit në këtë vendimmarrje, është gjetur në zbatim të gabuar dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal material dhe procedural. Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë vendim, bazuar në nenin Dh të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të DSIK-së, rezultateve të hetimit lidhur me çështjen e referuar më lart dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë subjekti, krijoi bindjen se informacioni që disponohej në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, sipas kërkesave të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë vendimmarrje, ishte i bazuar në fakte dhe rrethana konkrete: [...] *përfundimi i arritur në vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk është i bazuar në ligj dhe në prova, pasi në rastin konkret, rezultoi se: - nuk janë vlerësuar drejt provat bazuar në nenet 8/a dhe 152 të Kodit të Procedurës Penale, pasi sikurse rezultoi nga aktet, përfundimi i gjykatës lidhur me kuptimin e rrethanave ligjore të “përdorimit vetjak” dhe atij “në doza të vogla” është arritur vetëm mbi bazën e konkluzioneve sipërfaqësore të bëra në seancën gjyqësore dhe konkluzionet e specialistes kanë qenë të pamjaftueshme, pasi nuk janë përmendur prej saj argumente të dokumentuara shkencore; si dhe – është zbatuar gabim ligji procedural, pasi nuk figuron që të jenë respektuar kërkesat e dispozitave të neneve 179 dhe 185 të Kodit të Procedurës Penale (vendimi i organit procedues për caktimin; mendimi i ekspertit jepet me shkrim etj.). Trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe sa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 16.01.2008, ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, marrë nga subjekti i rivlerësimit, është i pabazuar dhe duhet të cenohet.*

130. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtimin e këtij konkluzioni, ka pretenduar se çështja në fjalë i përket vitit 2004 dhe është marrë në shqyrtim nga Komisioni në kundërshtim me përcaktimet në pikat 3 dhe 4 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, që përcaktojnë se perioda për të cilën subjektet i nënshtrohen vlerësimit të aftësisë profesionale është ajo e 3 viteve të fundit nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 84/2016, përjashtimisht dhe me kërkesë, vlerësimi mund të bëhet edhe për periudhën që fillon nga data 1 janar 2006. Po ashtu, subjekti ka pretenduar se Komisioni ka konkluduar se vendimi është dhënë nga subjekti i rivlerësimit në interpretim të gabuar të ligjit material dhe procedural, duke mos arsyetuar mbi rrethanat apo veprimet të cilat përfshihen në një nga rastet e parashikuara në shkronjat “a” deri “ç” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016.
131. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vëren se, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.03.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në të cilin subjekti paraqitet në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, është vendosur: [...] *Deklarimi fajtor i S. M., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe kryer më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 283/2 e 51 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim. Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve E. L., M. H., E. I., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale [...].* Pas ankimit të ushtruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2005, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. {\*\*\*} të datës 23.03.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, sa u përket shtetasve S. M., E. L., E. I. Ndryshimin e vendimit sa i përket shtetasit M. H. dhe deklarimin fajtor për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve në bashkëpunim”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim [...]”. Në vijim, pas rekursit të paraqitur nga Prokuroria e Apelit Durrës<sup>27</sup>, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 16.1.2008, ka arsyetuar, ndër të tjera, se duke përjashtuar pjesën që i përket të gjykuarit S., të dyja këto vendime ishin të pabazuara dhe duhet të cenohen.
132. Trupi gjykues vlerëson se, në shqyrtimin e këtij rasti, i cili konstatohet se i referohet veprimtarisë profesionale të subjektit të rivlerësimit në vitin 2004, jashtë periudhës së rivlerësimit, si në rastet e analizuara më sipër në këtë vendim, në kuadër të vlerësimit të kriterit të kontrollit të figurës, pavarësisht përfundimit të Gjykatës së Lartë për vendimmarrje të cënueshme të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ku subjekti ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, ky konstatim vlerësohet i pamjaftueshëm për arritjen nga Komisioni në konkluzionin se, sipas bindjes së këtij të fundit, *informacioni që disponohej në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, sipas kërkesave të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë vendimmarrje, ishte i bazuar në fakte dhe rrethana konkrete.*

---

<sup>27</sup> Rekursi me nr. {\*\*\*} prot., datë 05.01.2006.

#### ***D. Lidhur me vlerësimin e shkaqeve të ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale***

133. Lidhur me kriterin e vlerësimit profesional, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka arritur në konkluzionin se: [...] edhe nëse mangësitë e konstatuara në vendimet e analizuara të subjektit, në dosjet e shortuara, nuk do të mjaftonin për të kualifikuar subjektin të paaftë profesionalisht, sipas parashikimit të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, referuar problematikave dhe mangësive të evidentuara, në një vlerësim tërësor të rrethanave dhe procedurave, ato do të ishin të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
134. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtimin e këtij konkluzioni, ka pretenduar se përfundimet e arritura nga Komisioni në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, janë pasojë e zbatimit selektiv të dispozitave ligjore dhe jo e analizës në tërësi të tyre dhe, për rrjedhojë, nuk krijojnë kushtet për vlerësimin e tij si i papërshtatshëm. Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi si vijon.
135. Lidhur me denoncimin nga shtetasi A. B.<sup>28</sup>, në të cilin ngriheshin pretendime në lidhje me çështjen penale me nr. {\*\*\*/2015, me të pandehur shtetasin S. S., të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, në drejtim të zvarritjes së gjykimit dhe zbutjes së masës së dënimit ndaj të pandehurit, me qëllim favorizimin e tij, si dhe se subjekti gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me të pandehurin, pasi punonte si pedagog në të njëjtin institucion arsimor me kunatën dhe bashkëshorten e tij, trupi gjykues vëren si vijon.
136. Komisioni, lidhur me shqyrtimin e këtij denoncimi, ka konkluduar duke arsyetuar se: [...] Masa e sigurimit e vendosur nuk është në përputhje me nenin 229/2 të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk mban në konsideratë rëndësinë e faktit dhe vazhdimësinë, përsëritjen dhe rrethanat rënduese lidhur me të pandehurin, parashikuar nga Kodi Penal. [...] Shpjegimet e subjektit në lidhje me konstatimin se procesi gjyqësor është zvarritur, mbeten në nivel deklarativ, pasi në procesverbalet e seancave nuk argumentohen arsyet e kësaj kohëzgjatjeje dhe/apo shtyrja e seancave nuk bazohet në shkaqe të justifikuar ligjorisht. Gjykata lejohet ta ndërpresë shqyrtimin gjyqësor deri në 15 ditë, vetëm për raste të veçanta. Në nenin 342 të Kodit të Procedurës Penale, është përcaktuar se kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundohet në një seancë, gjykata vendos vazhdimin ditën e mëpasshme të punës. [...] Komisioni vlerësoi se subjekti nuk paraqiti asnjë provë për sa iu kërkua për të provuar, nëse për shkak të njohjes prej marrëdhënieve të punës me kunatën dhe bashkëshorten e të pandehurit, ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit për të cilin duhet të hiqte dorë nga gjykimi i çështjes së mësipërme. Lloji i vendimmarrjes, shpjeguar nga subjekti, në vlerësim të trupit gjykues, nuk përjashton subjektin e rivlerësimit nga detyrimi ligjor për heqjen dorë prej shqyrtimit të kësaj çështjeje.
137. Në kundërshtimin e konkluzioneve sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, për zëvendësimin e masës së sigurimit ndaj të pandehurit, është bazuar në bindjen e tij të brendshme, duke bërë një analizë kumulative të gjendjes mjekësore dhe rezultatit të hetimeve nga ana e

<sup>28</sup> Regjistruar me nr. {\*\*\*/} prot., datë 08.10.2020, i cili është administruar edhe nga Kolegji.

prokurorisë, në raport me rëndësinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e tij, në përputhje me kushtet e parashikuara prej neneve 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të neneve 15, 16, 17 të Kodit të Procedurës Penale, fakt i cili, sipas tij, gjen mbështetje edhe nga vendimi i fajësisë së dhënë prej tij ndaj të pandehurit, i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës. Sipas subjektit, çështja objekt vlerësimi gjykohej me tre gjyqtarë, të cilët duhet të koordinonin për ngarkesën, çka ka sjellë vonesa në gjykimin e saj dhe relatimi i këtyre shkaqeve të vonesave është dokumentuar me regjistrimin audio të seancave.

138. Në kuadër të shqyrtimit të këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga analiza e akteve të ndodhura në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstatoi se, me vendimin nr. {\*\*\*}, të datës 23.12.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka caktuar ndaj të dyshuarit S. S., masën e sigurisë “Arrest me burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Në vijim, me kërkesë të shtetasit të sipërcituar<sup>29</sup>, kjo gjykatë me trup gjykues në të cilin subjekti ishte kryesues, në datën 29.01.2016, ka vendosur: *Zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest me burg” në masë sigurimi “arrest në shtëpi”, parë në harmoni me situatën shëndetësore të të pandehurit, nevojat e sigurimit janë zbutur dhe nuk është evident rreziku i largimit të të pandehurit apo rreziku i vërtetësisë ose manipulimi i provave.*
139. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka paraqitur për gjykim kërkesën me objekt “Dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2015, me të pandehur shtetasin S. S. dhe deklarimin fajtor për kryerjen e veprave penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal dhe “Kundërshtim të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal. Më pas, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 04.04.2016, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal dhe “Kundërshtim të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal, dhe bashkimin e dënimeve bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 1 vit e 6 muaj burg. Në zbatim të nenit 406/1, uljen e dënimit përfundimisht me një vit burg”.
140. Trupi gjykues, në analizë të parashikimeve të nenit 230/2 të Kodit të Procedurës Penale, konstaton se vendosja e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” ndalohet në kushtet kur personi ndodhet në një gjendje veçanërisht të rëndë shëndetësore. Në rastin konkret, sipas aktit të epikrizës mjekësore, i pandehuri ka qenë duke u trajtuar në Spitalin Rajonal të Elbasanit. Nga ana e ekspertëve, nuk është dëshmuar mbi pamundësinë e mjekimit dhe ndjekjes së terapive përkatëse, në një institucion të specializuar mjekësor. Po ashtu, trupi gjykues, në analizimin e kësaj çështjeje,

---

<sup>29</sup> Kërkuesi/i pandehuri, bashkë me kërkesën, ka paraqitur edhe epikrizën përkatëse shëndetësore me nr. {\*\*\*} prot., datë 20.01.2016, ku citohet se: “Shtetasi S. S. shpeshherë bëhet ankthioz, i gatshëm për t’u konfrontuar me të tjerë dhe duhet të jetë vazhdimisht nën kontroll”.

çmon të sjellë në vëmendje edhe qëndrimin e mbajtur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë<sup>30</sup>, në të cilin, ndër të tjera, arsyetohet se gjendja shëndetësore nuk përbën, në vetvete, shkak për mosaplikimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”. Ekzistenca e një gjendjeje veçanërisht të rëndë shëndetësore duhet të provohet me akt ekspertimi mjekoligjor, i cili duhet të përcaktojë jo vetëm rëndësinë e gjendjes, por edhe pamundësinë e qëndrimit të personit në izolim ose në kushtet spitalore të burgut. Në përputhje edhe me jurisprudencën e GjEDNj-së, ndryshimi i masës justifikohet vetëm kur autoritetet nuk mund të sigurojnë trajtimin e nevojshëm mjekësor dhe mungesa e tij rrezikon jetën ose shëndetin e personit. Vlerësimi bazohet në gjendjen shëndetësore konkrete, përshtatshmërinë e kujdesit mjekësor të ofruar dhe proporcionalitetin e masës së sigurimit në raport me këtë gjendje. Për rrjedhojë, ndryshimi i masës mund të bëhet vetëm kur provohet ndryshimi i rrethanave mbi të cilat ajo është caktuar dhe zbutja e nevojave të sigurimit.

141. Në këtë optikë, trupi gjykues vëren se në vendimin objekt shqyrtimi, është arsyetuar ndryshimi i masës së sigurimit të arrestit në burg, duke konsideruar kushtet mjekësore të kërkuesit, ndërkohë që nuk është provuar pamundësia e mjekimit dhe e ndjekjes së terapive mjekuese si në institucionin mjekësor ku trajtohen të paraburgosurit, ashtu edhe në një institucion të specializuar mjekësor.
142. Në vështrim të analizës së mësipërme, trupi gjykues gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit se, në vendimmarrjen objekt analize, nuk janë respektuar kërkesat e neneve 229/2 dhe 230/2 të këtij Kodi.
143. Në lidhje me shqyrtimin e pretendimit të subjektit të rivlerësimit se ai nuk gjendej në kushtet e nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale, trupi gjykues vlerëson se fakti që subjekti ka pasur njohje prej marrëdhënieve të punës me kunatën dhe bashkëshorten e të pandehurit (sipas deklarimeve të tij gjatë procesit të rivlerësimit), ai ka pasur detyrimin që të hiqte dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, me qëllim shmangien e perceptimit për cenimin e paanësisë së gjyqtarit. Ndërsa, konstatimet e Komisionit për zvarritje të procesit në çështjen objekt vlerësimi, u vlerësuan nga trupi gjykues pa peshë në drejtim të vlerësimit të kësaj çështjeje.
144. Në përfundim, trupi gjykues çmon se vendimmarrja e subjektit në çështjen e analizuar më sipër, duhet të vlerësohet konform indikatorit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, sipas parashikimit të nenit 75, pikat 3 e 4 të ligjit nr. 96/2016. Në kuptim të kësaj dispozite, trupi gjykues çmon se subjekti ka cenuar integritetin dhe paanësinë e magjistratit, duke demonstruar mosrespektim të detyrimeve që i vijnë atij si zyrtar dhe funksionar i rëndësishëm publik, në dëm të funksionimit të shtetit të së drejtës e të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
145. Lidhur me vendimin me nr. {\*\*\*} të datës 16.04.2019, ndaj të pandehurit L. D., denoncuesi A. B. ka pretenduar se masat e sigurimit janë dhënë nga subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me provat dhe kriteret e K.Pr.Penale. Po ashtu, vendimi i dhënë nga subjekti ka mangësi dhe mungesë të arsytimit ligjor lidhur me cilësimin ligjor të veprës penale dhe çmuarjes së provave konform nenit 152 të K.Pr.Penale.

---

<sup>30</sup> Shih paragrafët 37-38 të vendimeve të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: nr. {\*\*\*} dhe të vendimit nr. {\*\*\*}, paragrafët 51-54.

146. Trupi gjykues konstaton se Komisioni, lidhur me këtë çështje, ka arritur në përfundimin se: *Vendimet gjyqësore objekt vlerësimi, sa më sipër referuar nga denoncimi, merren në konsideratë dhe vlerësohen në drejtim të mungesës së analizës ligjore dhe argumentimit, sikundër Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në vendimin orientues (JR) 21/2019, shprehet se: “[...] konsideron me rëndësi që për vlerësimin e aftësive profesionale, vëmendje t’i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku [...], kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016”. Sa më sipër, gjetjet lidhur me vendimet e analizuara referuar denoncimit të administruar sipas nenit 53 konsiderohen të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
147. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të pabazuar në ligj përfundimin e arritur nga Komisioni, duke argumentuar se në caktimin e masës së sigurimit ndaj të pandehurit, është bazuar në bindjen e brendshme, të krijuar nga shqyrtimi në tërësi i provave të administruara në gjykim.
148. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikull<sup>31</sup>, konstatoi se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në datën 14.04.2014, ka kërkuar vlefësimin e ligjshëm të ndalimit në flagrancë dhe caktimin si masë sigurimi personal “arrest me burg” për shtetasit A. Q., L. Gj. dhe L. D., për veprën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Me vendimin nr. 296 të datës 16.04.2019, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, ka vendosur: “Vlefësimin e ligjshëm të ndalimit në flagrancë dhe caktimin si masë sigurimi personal “arrest me burg” për shtetasit A. Q., L. Gj. dhe L. D., masën e sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, duke mbajtur parasysh gjendjen e provave për të ndaluarin dhe që nuk paraqet rrezikshmëri të veçantë, si dhe i ndaluarin ka vetëm një kontakt me shtetasin S. P., pranuar dhe vetë nga organi i akuzës. Në vijim, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 08.05.2019, ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 16.04.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, zëvendësimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, me masën “arrest në burg”, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, për personin nën hetim L. D..*
149. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, ka shpjeguar se nga provat e paraqitura në gjykim nga ana e organit të prokurorisë, rezultoi se shtetasi L. D. ka pasur vetëm një kontakt me shtetasin S. P., gjatë të cilit nuk është vëzhguar dhe dokumentuar shkëmbimi apo posedimi i lëndëve narkotike. Po ashtu, subjekti ka argumentuar se në përcaktimin e masës së sigurimit personal “detyrim paraqitje”, pavarësisht se i ndaluarin dyshohej për një vepër penale që parashikon si lloj dënimi vetëm atë me burgim, ai nuk paraqiste rrezikshmëri të veçantë shoqërore. Subjekti është shprehur se, në caktimin e kësaj mase ndaj të pandehurit, ka mbajtur në konsideratë personalitetin e të pandehurit, gjendjen e tij shoqërore, si dhe në veçanti gjendjen e provave të grumbulluara deri në atë fazë të hetimit nga organi procedues, duke konkluduar se “detyrimi për paraqitje në policinë gjyqësore” ishte masa më e përshtatshme për të pandehurin L. D..

---

<sup>31</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 22.02.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka përcjellë dosjen penale me nr. {\*\*\*}/2019.

150. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur rrëzimin e kërkesës për ndryshimin e masës së sigurimit personal të caktuar nga Gjykata e Apelit Durrës në ngarkim të shtetasit L. D., sipas vendimit nr. {\*\*\*} të datës 29.07.2019. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 08.05.2019, ka vendosur ndryshimin dhe caktimin si masë sigurimi “arrest me burg” ndaj të dyshuarit L. D.
151. Trupi gjykues vëren se kriteret e parashikuara nga neni 229 i K.Pr.Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret.
152. Duke mbajtur në konsideratë se në rastin konkret, nga hetimi, ka pasur indicie që ngrenë dyshime të arsyeshme (siç është edhe kontakti i të pandehurit me shtetasin S. P.) se i pandehuri ka konsumuar veprën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, e cila është një vepër penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore për shkak të marrëdhënies juridike e cila cenohet, parashikimit të saj si krim, si dhe sanksionit penal me marzh dënimi me burgim nga 5 deri në 10 vjet, trupi gjykues arrin në përfundimin se masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, e vendosur nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore për të dyshuarin L. D., nuk pajtohet me kërkesat e nenit 230 të K.Pr.Penale, për sa kohë ka rezultuar i provuar dyshimi për kryerjen nga i pandehuri të veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Për rrjedhojë, arrihet në përfundimin se dhënia e masës së sigurimit nga subjekti, është bërë në kundërshtim me përcaktimet në nenin 230/2 të Kodit Penal.
153. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues, sikurse edhe Komisioni, vlerëson se problematikat e konstatuara lidhur me këtë kriter, ndonëse u gjetën të pamjaftueshme për të konkluduar se subjekti është i papërshtatshëm për të vijuar ushtrimin e detyrës në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, u mbajtën në konsideratë nga trupi gjykues në vlerësimin në tërësi të çështjes sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të efektit të veprimtarisë profesionale të subjektit në drejtim të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
154. Në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve, në kuptim të nenit 2, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, përdorimi nga subjekti i rivlerësimit i automjeteve në pronësi të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe të shtetasit V. B., si dhe problematikat në përmbushjen e detyrës, lidhur me dhënien nga subjekti i rivlerësimit të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr. {\*\*\*}, datë 09.12.2020, dhe nr. {\*\*\*}, datë 24.12.2018, u çmuan nga trupi gjykues të një rëndësie të tillë që cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në zbatim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
155. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 5 e të njëjtit ligj. Për rrjedhojë, vendimi nr. 649, datë 24.04.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë, i bazuar në fakte e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 649, datë 24.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Taulant Tafa.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 30.09.2025, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*